

Arsimi i lartë për Minoritetet në Kosovë

Diskutim ndërkombëtar mbajtur në Prishtinë
më 18 maj 2006

Prishtinë, shtator 2006

Këtë publikim e ka financuar
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Shtypi dhe disenji
Printing house Adnan Reznqi Company

Kopje:
500
Prishtinë, 2006

Diskutimi njëditor ndërkombëtar „Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë“ u mbajt në Prishtinë, më 18 maj 2006, organizuar nga Forumi 2015 në bashkëpunim me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC). Në diskutim, ekspertë të spikatur kosovarë dhe ndërkombëtarë prezantuan analiza lidhur me situatën mbizotëruese, zgjidhjet e mundshme dhe perspektivat e së ardhshmes për shërbimet e arsimit të lartë për minoritetet në Kosovë.

Çka është Forumi 2015?

Forum 2015 është koalicion i pavarur i dy organizatave joqeveritare, Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe RIINVEST-it, i themeluar më 2003 me qëllim të përkrahjes së iniciativave qeveritare dhe joqeveritare për integrimin e Kosovës në strukturat euro-atlantike. Forumi 2015 është një projekt i rëndësishëm i KFOS-it dhe RIINVEST-it, që synon të ofrojë hapësirë për debate përmbajtësore në mes të përfaqësuesve të qeverisë, partive politike, shoqërisë civile, sektorit privat dhe intelektualëve të pavarur. Forumi po ashtu synon të mobilizojë intelektualët e vendit për të studiuar dhe analizuar çështje madhore me të cilat ballafaqohet shoqëria Kosovare. Forumi 2015 do të bëjë rekomandime dhe do të nxisë iniciativa në sektorët përkatës të strategjive publike, duke promovuar idenë për qeverisje të mirë, për zhvillimin e institucioneve demokratike dhe për integrimet euro-atlantike.

Përmbajtja:

Fjalimi kryesor

“Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë
– problemet, zgjidhjet, mësimet”

11

Georg Woeber,

ekspert ndërkombëtar
i arsimit të lartë i Agjencisë
Austriake për Zhvillim dhe OSBE-së

Analiza kryesore

Ëndrra për arsimim shumetnik
– trillim dhe realitet në arsimin e lartë në Kosovë sot”

Dukagjin Pupovci,

Drejtor i Qendrës për
Arsim të Kosovës (KEC)

21

Analiza kryesore

“Përgjegjësitë e bashkësisë ndërkombëtare për arsimin e
lartë të minoriteteve në Kosovë – dita pas vendosjes së statusit”

Alexander Bayerl,

Presidenca e BE-së,
Shef i Zyrës Ndërlidhëse
të Austrisë në Kosovë

29

Rasti i studimit 1

“Universiteti i Bozenit/Bolzanos
– një tregim suksesi tregjuhësh në Evropë”

Oswin Maurer,

, Prorektor, Universiteti i Bozenit/Bolzanos, Itali

35

Rasti i studimit 2

“Sfidat dhe zgjidhjet për arsimin e lartë
të minoriteteve në Rumani”

Mircea Bocsan,

ligjërues, Universiteti Babes-Bolyai, Kluzh, Rumani

41

Rasti i studimit 3

“Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë
– prej sfidës politike në sukses akademik”

Dennis Farrington,

ekspert ndërkombëtar i arsimit të lartë i Këshillit
të Evropës dhe i Asociacionit të Universiteteve Evropiane

45

Parathënie

Me organizimin e kësaj konference, "Forumi 2015" synon hapjen e një dialogu të mirëfilltë për adresimin e një aspekti të rëndësishëm të arsimit të minoriteteve në Kosovë, në dritën e përpjekjeve të kosovarëve për të qenë pjesë e integriteteve evropiane. Diskutimi u organizua në kohën kur zhvilloheshin bisedimet intensive në mes të Prishtinës dhe Beogradit me ndërmjetësimin e komunitetit ndërkombëtar, dhe kur pritej që çështja e arsimit të minoriteteve të hidhet në tryezën e bisedimeve, prandaj ishte e pamundur që konferenca t'i shmanget ndikimeve që sjellin proceset e tilla.

Pa marrë parasysh kufizimet objektive, u arrit një shkallë e lartë e konsensusit se Kosova është në gjendje dhe ka obligim të sigurojë kushte për ofrimin e arsimit të lartë në gjuhët e minoriteteve, në radhë të parë në gjuhët sllave, ndërsa sipas mundësisë dhe nevojës, edhe në gjuhën turke. Për më tepër, duhet ndërtuar mekanizma për të siguruar bashkëveprimin e grupeve gjuhësore të ndryshme brenda komunitetit akademik kosovar, qoftë në nivel të institucioneve akademike, apo në nivel të stafit akademik dhe të studentëve. Vendi që pretendon të jetë pjesë e integriteteve evropiane dhe e Procesit të Bolonjës duhet të sigurojë parakushte për funksionimin e një Hapësire Kosovare të Arsimit të Lartë, në mënyrë që të bëhet pjesë përbërëse dhe e pandashme e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë – koncept tashmë i njohur në Evropë.

Në këtë konferencë u prezantuan shembuj të praktikës së mirë nga vende të tjera, me të cilat u dëshmuar se ekzistojnë modele funksionale për plotësimin e nevojave të grupeve minoritare për arsim të lartë. Gjithashtu, u theksua se infrastruktura ligjore në Kosovë ofron mundësi për organizimin e arsimit të lartë në gjuhën e minoriteteve, ndërkohë që ekziston gatishmëria e institucioneve të Kosovës që procesin e integritetit të komunitetit serb në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë ta përkrahin moralisht dhe materialisht.

Në kohën e publikimit të materialeve të kësaj konference, bisedimet e Vjenës sikur po i afrohen fundit, ndërkohë që është edhe më i theksuar paralelizmi në sistemin e arsimit, më konkretisht, institucionet arsimore që zhvillojnë punën në gjuhën serbe refuzojnë çfarëdo financimi nga institucionet e Kosovës. Megjithatë, "Forumi 2015" beson se dialogu ndëretnik rreth çështjeve të arsimit të lartë duhet të vazhdojë edhe më tutje, prandaj edhe e shihet arsyeshme të publikojë broshurën që përmban disa ide të mira rreth zgjidhjes së problemeve në këtë fushë, pa pretenduar aspak se nuk mund të gjenden zgjidhje më të mira dhe më të pranueshme për të gjitha palët.

Prishtinë, shtator 2006

Dukagjin PUPOVCI

Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë

—

problemet, zgjidhjet dhe mësimet

Georg L.F. Woeber, Vienna/Austria

Ekspert ndërkombëtar i arsimit të lartë për OSBE-në dhe për

Agjencinë Austriake për Zhvillim

Këshilltar i Ministrit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë së Kosovës

1. Pikëvështrime hyrëse

Personalisht jam i involvuar si ekspert në çështjet e arsimit të lartë për minoritetet në Kosovë që nga viti 2001. Nuk është mirë të fillosh me konstatimin se në ndërkohë ka pasur fare pak ndryshime dhe pak zhvillim. Unë e shoh këtë seminar të sotëm edhe si një thirrje për t'u zgjuar. Është kjo një thirrje për opinionin publik të Kosovës, për njerëzit të cilët duhet të vendosin. Në të vërtetë populli do të duhej të dërgonte mesazhin tek politikanët, ndërkaq këta të dytët do të duhej të zbatonin përmbajtjen e atij mesazhi. Ajo që na duhet ne ekspertëve është mesazhi: Çka dëshironi ju? Kur? Ku dhe si?

Vet termi arsim i lartë për minoritetet është një term politik e jo term teknik. Kjo edhe shpjegon vështirësitë në të cilat hasin disa nga ekspertët pranë kësaj tryeze sot. Unë këtu sot flas si teknik, por gjithashtu edhe me një sy kah politika. Pyetja në të cilën duhet të përgjigjemi është: Çka duhet të transformohet nga vizioni politik në zbatim teknik? Më lejoni të filloj me disa pyetje provokuese.

Të bëhemi sikur një institucion i tillë i arsimit të lartë ekziston. Çka do të duhej të bënte ky universitet? A mos do të duhej që ky institucion të identifikonte një student minoritar - a është ai i zeshkët, ose më i gjatë se 1.80 m, ose më i ri se nëntëmbëdhjetë vjeç? A do të përgatitet një orar i veçantë për të, të hartohen studime të posaçme për të, apo të rezervohen lokale të veçanta për të? Ose ta vendosim në një perspektivë edhe më të keqe, a do t'i vendosim studentët minoritarë në geto? Kuptohet se jo! Prandaj, pyetja e ardhshme është: a është kjo vetëm çështje e gjuhës, a është çështje politike, apo mbase diçka më shumë? Dhe duke u kthyer prapa në pyetjen fillestare dhe duke iu përgjigjur në të njëjtën kohë: a nuk është qasja shumëgjuhësore ai mesazhi i kërkuar për arsimin e lartë të sotëm në Evropë?

Në universitetin ku i kam kryer studimet unë në Austri, programi im i studimeve "Përpunimi i naftës" është zhvilluar në gjuhën e parë angleze, jo në gjuhën gjermane! Prandaj, pse do të duhej të ishte problem zhvillimi i studimeve në universitete në disa gjuhë? Apo mos do të duhej të kemi diçka tjetër para sysh ... ? Të gjitha këto duhet parë në kontekstin e historisë së sistemit të arsimit të lartë në Kosovë dhe nga perspektiva e shqyrtimeve strategjike të sistemit arsimor të Kosovës sot.

2. Një histori e shkurtër e arsimit të lartë në Kosovë

Universiteti i Prishtinës (UP) është themeluar kah fundi i viteve të gjashtëdhjeta. Duke qenë universiteti i ri, sikur edhe universitete të tjera të ngjashme në gjithë Evropën, ky universitet ballafaqohet me traditë joadekuate të hulumtimit shkencor dhe të mësimdhënies. Zakonisht kërkohen një deri dy breza për të krijuar një themel më serioz akademik. Për habi, në një prezantim tjetër sot do të mësojmë për një universitet tjetër të ri, Universiteti i Bozen-it në Itali, i cili tashmë ka krijuar këtë themel akademik (fshehtësia prapa këtij suksesi është paraja – shumë para).

Universiteti i Prishtinës gëzoi vitet e veta të rritjes në vitet 1970 dhe 1980. Fillimisht u themeluan disa fakultete të reja dhe pastaj ato u ndanë më tej. Ndarjet etnike ndërmjet personelit serb dhe shqiptar filluan gjatë viteve të tetëdhjeta dhe përfunduan me ndarjen e plotë dhe me sistemin paralel në fillimin e viteve të nëntëdhjeta.

Kjo ndarje, të cilën shumica e të pranishmëve në këtë sallë e kanë përjetuar nga këndvështrimi politik, paraqet po ashtu, edhe një prerje shumë dramatike teknike në historinë e këtij universiteti. Kur punëtorët akademikë zhvendosen nga lokalet e veta, kur ata e humbin infrastrukturën e vet të mësimdhënies dhe të hulumtimit shkencor, ata faktikisht dalin nga procedurat normale; një gjë e tillë ndodhi edhe me komunitetin akademik shqiptar: ata u sollën në një gjendje të ngrirjes.

Pastaj erdhi kthesa e madhe prej njëqindetëdhjetë shkallësh e vitit 1999, kur komuniteti akademik shqiptar u kthye në lokalet universitare – apo të asaj që kishte mbetur nga to. Prej atëherë, do të thosha se arsimit të lartë kosovar është në një rrugë të përparimit “me plotë gropa e gunga në të”. Ministri Veliu, në fjalimin e tij të hapjes, i përmendi “vitet e humbura” për shkak të problemeve të vazhdueshme në rektorat.

Pjesa serbe e ish-Universitetit të Prishtinës u zhvendos në vitin 1999 dhe u riaktivizua në veri të Kosovës në vitin 2001.

3. Realiteti i sotëm – në të dyja anët

Universiteti i Prishtinës ende përballet me vështirësi të gjeneratës së humbur prej vitit 1991 deri në vitin 1999. Kjo ka të bëjë si me mësimdhënësit e hulumtuesit, ashtu edhe me studentët. Shumica e udhëheqësve të sotëm të parlamentit të studentëve janë regjistruar në studime që në vitet e nëntëdhjeta.

Universiteti i Prishtinës duhet të përballet me një zbrazëti dhjetëvjeçare të veprimtarisë akademike në universitet gjatë një periudhe kur ai ka mundur të bëjë hapa të rëndësishëm zhvillimor në brezin e dytë dhe të tretë akademik. Tensioni mendor i pranishëm në personelin akademik ndërmjet qasjes paralele (anarkike), e cila rrjedh nga sistemi paralel i viteve të nëntëdhjeta, dhe veprimi serioz i tipit “tani ne udhëheqim” është ende sot e kësaj dite shumë i pranishëm në punën e përditshme.

Pos kësaj, universiteti ballafaqohet edhe me problemin e madh të kontratave të shumta. Shumë profesorë të universitetit kanë kontrata të dyfishta ose të trefishta me universitete private ose me institucione ndërkombëtare. Sistemi i të ardhurave është kthyer krejtësisht përmbys – një profesor i ri universiteti fiton 280 € në muaj, ndërsa një student, përkthyes

në UNMIK ose në OSBE, mund të fitojë madje dy herë më shumë.

Hulumtimet në universitet u desh të fillonin thujse prej fillimit pasi që nuk kishte mbetur ndonjë traditë hulumtimi.

Universiteti i Mitrovicës (UM) – e pranoj se ky term teknik është edhe term politik – kishte përparësinë se realizonte veprimtari të mirëfilltë në vitin 1990. Ata mund të zhvillonin mësimdhënie dhe hulumtime.

Ndërkaq, sot monedha është kthyer në anën tjetër. Tani ata ballafaqohen me mungesa të theksuara infrastrukturore: kompleksi qendror në Mitrovicë ende funksionon me nivel të ulët dhe të përkohshëm sa i përket laboratorëve, bibliotekave, instrumenteve teknike, etj. Ndërmjet viteve 2001 dhe 2004 Universiteti i Mitrovicës kaloi nëpër një “pranverë të Mitrovicës”, siç e quaj unë. Gjatë kësaj periudhe ndjehej një lëvizje politike kah integrimi në sistemin kosovar të arsimit të lartë dhe një përkushtim për t’u hyrë reformave.

Por, pastaj erdhi tronditja e madhe e vitit 2004, kur rektori i ligjshëm Saviq u shkarkua dhe në vend të tij Beogradi instaloi Profesorin Papoviq si “rektor” të ri.

4. Një histori edhe më e shkurtër e Universitetit të Mitrovicës

Po e bëj këtë shqyrtim paksa më të thellë në rastin e Mitrovicës, pasi që nuk kemi asnjë opsion tjetër për arsimin e lartë për minoritetet në Kosovë, por edhe sepse paraqet një aspekt të çështjeve që po i shqyrtojmë.

Fillimi i punës së Universitetit të Mitrovicës prej zeros në vjeshtën e vitit 2001 ishte një fillim i vështirë, por edhe një gjë mahnitëse, sidomos nga aspekti financiar. Rreth 8 deri 10 milionë euro ishin investuar prej vitit 2001 vetëm për qëllim të rivendosjes së infrastrukturës themelore të nevojshme për funksionimin e universitetit. Sot, pothuajse dy të tretat e investimeve infrastrukturore janë përfunduar.

Gjatë “Pranverës së Mitrovicës” kishte një lëvizje të fuqishme drejtë reformave dhe kah integrimet e fakulteteve. Katërmëdhjetë fakultete nuk do të përshtateshin me një numër prej 4 deri 5 mijë studentë. Kësisoj, hapi i parë ishte ulja e numrit të fakulteteve prej 14 në 10 dhe planifikohej që të vazhdohej me këtë trend duke e zvogëluar numrin në 8 dhe, më në fund të përfundohej procesi me 6 fakultete. Mirëpo, këtu u ndërpreu reformat. Ky proces reformues po ashtu përfshinte edhe zbatimin e programeve modulare të studimit. Për shembull, në studimet teknike, secili student mund të fillonte në vitin e parë dhe pastaj të vendoste se në cilat programe studimi donte të vazhdonte. Rregullat e Bolonjës dhe të ECTS-së kishin filluar të implementoheshin, si dhe një model i dy komplekseve universitare po zhvillohej ndërmjet Mitrovicës dhe Leposaviqit.

Të gjitha këto u ndërpreu në prill të vitit 2004, faktikisht në momentin e fundit para se Universiteti i Mitrovicës të integrohej në kornizën ligjore të Kosovës. Prej asaj kohe, ky universitet vuan pasojat e izolimit ndërkombëtar për arsye politike dhe, është ky realitet me të cilin duhet ballafaquar sot.

5. Kërkesa për arsim të lartë për minoritete

Me siguri se çështja themelore për arsimin e lartë për minoritetet është plotësimi i kërkesave gjuhësore – dygjuhësore dhe shumëgjuhësore. Mbase nuk do të ishte strategji fort e mençur të themelohej një universitet ku mësimi do të mbahej për secilën gjuhë minoritare – serbe, boshnjake, turke, etj. Një institucion i tillë do të përfundonte me grupe prej 2-3 studentëve në vitin e parë dhe pa asnjë student në vitin e tretë.

Kështu, mesazhi dhe vizioni i parapëlqyer mbështetës do të duhej të ishte futja në zbatim e arsimit të lartë shumëgjuhësor në Kosovë. Më lejoni një vërejtje digresive. Tash do të shpallet konkursi për rektorin e Universitetit të Prishtinës. A nuk do të duhej që në kushtet e konkursit të futej edhe kërkesa për njohjen e shkëlqyeshme të gjuhës angleze? Deri më tani një gjë e tillë nuk është aplikuar, njësoj sikur edhe në zgjedhjet pas vitit 1999.

Në përgjithësi, strategjia e përgjithshme e arsimit të lartë në Kosovë duhet të zhvillohet dhe të zgjerohet me konceptin e arsimit të lartë për minoritetet. Një vizion i mundshëm afatgjatë do të mund të ishte që të bëhej gjuha angleze gjuhë e studimeve në fusha të caktuara studimore, dhe pastaj të vazhdohej me aspekte të arsimit shumëgjuhësor në spektrin prej gjuhës shqipe në atë serbe apo boshnjake, turke ose tjetër. Kjo gjithsesi nuk mund të jetë strategji e gjithmbarshme, mirëpo fillimi i zbatimit të dy-tri programeve në gjuhën angleze nuk do të bartte ndonjë rrezik të veçantë. Në ndërkohë do të mund të zhvilloheshin hulumtime lidhur me kërkesat e tregut të punës dhe përkitazi me interesimet e studentëve; të gjitha këto do të mund të sillnin konstatime mjaftë interesante dhe të dobishme për komunitetin ende konservativ akademik të Kosovës.

Më lejoni që edhe një herë t'i referohem përvojës nga vendi im dhe nga universiteti ku kam mbaruar studimet. Ne kishim rreth 5 studentë të rinj që vinin të studionin në programin tonë të studimit derisa ai zhvillohej në gjuhën gjermane. Mirëpo, kur programi studimor u transformua në gjuhën angleze, përnjëherë u regjistruan deri 50 studentë të rinj në vit, 80 % prej të cilëve ishin studentë të huaj. Kjo ngrit një pyetje tjetër. A është sistemi kosovar i arsimit të lartë i rezervuar vetëm për studentë kosovarë? Apo, a është ky pjesë e rrjetit universitar të Ballkanit apo madje edhe të Evropës juglindore? A duhet Kosova të zhvillojë një sistem të shtrenjtë studimi enkas për studentët e huaj që vijnë të studiojnë në këtë universitet? Apo, mbase, mos do të duhej që Kosova të orvatej të tërhiqte këta studentë?

Do të marr një shembull tjetër – shembullin e Universitetit Teknik të Cyrihut, i cili radhitet ndër universitetet më të njohura teknike në botë. Në studimet e doktoratës të këtij universiteti, më se 80 % e studentëve janë të huaj. Kur iu drejtuam rektorit të këtij universiteti lidhur me këtë fakt, duke e pyetur nëse kjo do të mund të paraqiste problem nga këndvështrimi nacional zviceran (i shpenzimit të parave të taksapaguesve për dobi të të huajve), ai u përgjigj me buzëqeshje duke thënë se universiteti po synonte të rriste pjesëmarrjen e studentëve të huaj të doktoratës në masën 90 %. Pse? Sepse ky është treguesi më i mirë i i atraktivitetit dhe i cilësisë akademike të institucionit, si dhe i kompetencës së lartë të personelit të tij akademik. Pikërisht këtë shembull do të duhej ta mbante në mend Kosova me rastin e vendosjes së kornizës së ardhshme zhvillimore të arsimit të lartë.

Arsimi i lartë minoritar është edhe një mundësi për sistemin kosovar të arsimit të lartë në tërësi për të zhvilluar cilësinë, kompetencën dhe profilin e vet ndërkombëtar. Mirëpo, kjo do të kërkonte edhe një riorientim fundamental të piramidës së tanishme të programeve studimore.

Edhe sot e kësaj dite, ende hasim si në Universitetin e Prishtinës ashtu edhe në atë të Mitrovicës një përqendrim të fuqishëm në studimet për magjistraturë apo Master; studimet për Baçellor – megjithëse janë një standard i pranuar evropian – ende nuk shihen si studime që sjellin diplomë të plotë akademike. Kjo shkon ndesh plotësisht me perspektiven më të mundshme të arsimit të lartë në Evropën e vitit 2020. Kjo perspektivë sheh një piramidë ku së paku 60 %, e mbase deri 80 %, e diplomave do të jenë Baçellor, ndërkaq pjesa e mbetur prej 20 – 30 % do të jenë Master dhe më pak se 5 % do të jenë doktoratura. Nga kjo del një pyetje tjetër. Përse të mos përqendrohemi më shumë në nevojat e tregut të punës, pasi që pikërisht ky aspekt e bën arsimin universitar më të çmuar për studentët. Përgjigja mbase do të ishte prapë se shumica do të parapëlqejnë një gradë Baçellori në moshën 23 vjeçare se sa një grade Master në fund të viteve të njëzeta me pasiguri të theksuara sa i përket rrogës.

Gjëja tjetër e rëndësishme derisa flasim për arsimin e lartë minoritar është Ku? dhe Si? – të cilat në thelb janë pyetje të thjeshta teknike. A do të mund të bindej një 18 vjeçar, i cili jeton në njërin nga enklavat, që të shkonte çdo ditë në ligjëratat me autobus, i përcjellë nga KFOR-i – ose mbase do të parapëlqente që mësimdhënësi t'i vizitonte atë dhe kolegët e tij rregullisht? Në thelb janë disa opsione, por ato duhet të sqarohen dhe të vlerësohen një nga një para se të zhvillohet plani për një universitet të tillë. Kush udhëton? Studenti, mësimdhënësi, apo mbase mësimi zhvillohet sipas modelit të mësimin në distancë? Për cilindo nga këto opsione ekzistojnë një sërë shembujsh dhe praktikash të mira në botë.

Çështja tjetër e rëndësishme është cilësia akademike. Arsimimi universitar gjithnjë ka të bëjë me cilësinë: me cilësinë e studentëve, me cilësinë e mësimdhënësve, por gjithashtu edhe me cilësinë e infrastrukturës. Ose thënë më saktë: nëse Kosova nuk ka mundësi të sigurojë infrastrukturë dhe pajisje cilësore për një institucion të tillë, atëherë më mirë të mos e bëjnë fare, me qëllim që të mos bëhet edhe një institucion tjetër i përkohshëm. Institucione të tilla të themeluara rishtazi, do të duhej të funksionojnë si duhet që në fillim, përndryshe do të vuajnë një vdekje të gjatë e plotë dhimbje. Në Kosovë mjafton një universitet i pajisur dobët. Dhe, në fund, çështja e cilësisë është edhe vendi ku opinioni publik dhe politikanët e Kosovës duhet t'i vendosin vetvetes piketat përkitazi me atë se "Ku dëshirojmë të shkojmë me vizionin tonë të arsimit të lartë"?

Aspekt tjetër që duhet shqyrtuar është një masë kritike e personelit të rregullt. Është e pamundur të mbahet një universitet në funksion në rrethana kur 90 % e mësimdhënësve udhëtojnë në të gjitha drejtimet, gjë që edhe ka qenë pjesë e realitetit të Universitetit të Mitrovicës ndërmjet viteve 2000 dhe 2002. Dhe në fund, por jo për nga rëndësia, një universitet mund të ofrojë shërbime profesionale për studentët e vet, vetëm nëse është plotësisht i njohur nga agjencione relevante ndërkombëtare dhe nëse i plotëson standardet themelore evropiane në kuptimin akademik (Bolonja, ECTS) dhe në aspektin e hulumtimeve shkencore.

6. Çka të bëhet me Universitetin e Mitrovicës?

Kjo është një nga pyetjet kryesore në mendjen e secilit prej nesh, por e cila nuk diskutohet shumë hapur. Njeriu mund t'i qaset kësaj pyetjeje nga aspekti politik ose nga ai operacional. Njeriu mund të thotë "Unë nuk po e shqyrtoj çështjen e Mitrovicës sepse Papoviq (ose cilido pasardhës tjetër i instaluar në mënyrë të paligjshme) është njeri i keq, ndërsa ne jemi djelmoshat e mirë". Dhe se "përderisa të jenë këta djelmoshat e këqij ne nuk do të diskutojmë opsione të tjera".

Po çka nëse pyetja kthehet në anën tjetër? Sa mësimdhënës të kualifikuar akademikë, të cilët janë në gjendje të japin mësim në gjuhët e minoriteteve, janë jashtë Universitetit të Mitrovicës por brenda Kosovës? Bëhet e qartë se ka vetëm një "kazan". Atëherë, cilat janë opsionet?

Opsioni i parë do të ishte të themelohej UM-ja si një universitet publik kosovar që do të funksiononte krejtësisht në bazë të legjislacionit kosovar. Tashmë ekziston korniza ligjore kosovare, statuti i universitetit do të siguronte një masë të caktuar të veprimit autonom; procesi i reformave, i cili u ndërpre në vitin 2004, do të rifillonte. Përse insistohet në reforma? Sepse momentalisht UM-ja kushton përafërsisht sa edhe UP-ja (më shumë se 12 milionë euro), mirëpo, në këtë rast, UP-ja mbulon rreth 88% të popullatës së Kosovës, krahasuar me 7-8 % të mbuluara nga UM-ja. Asnjë politikan kosovar nuk do të pranonte financimin e tillë në masën 50 %. Kështu, madhësia e UM-së do të duhej përshtatur realitetit të ri prej rreth 4-5000 studentë aktivë në plan afatgjatë. Numri i fakulteteve duhet po ashtu të zvogëlohet edhe më, si edhe numri i personelit, me qëllim të uljes së shpenzimeve të përgjithshme. Të gjitha këto janë të mundshme, dhe mund të kryhen brenda një periudhe 2-3 vjeçare.

Opsioni i dytë do të ishte ruajtja e statusit të tanishëm të UM-së si institucion serb i arsimit të lartë, dhe kundrimi i tij nga këndvështrimi i kornizës ligjore të Kosovës si institucion privat i financuar nga donatorë (Serbia). Ministri nuk do të brengosej se kush do të behej drejtor përderisa do të zbatoheshin rregulloret themelore. Teknikisht, kjo e fundit mbase do të ishte opsioni më i lehtë, sepse situatën e tanishme e transformon në situatë të ligjshme. Mbetet megjithatë një problem: në këtë rast do të humbej status i institucionit publik të arsimit të lartë.

Opsioni i tretë, i cili do të mund të quhej "modeli i Hong Kongut", do të mëtonte të lëvizte brenda kufijve të shumtë, dëshirave dhe linjave politike. Kjo do të shpjegohet më tutje në këtë tekst në mënyrë më të hollësishme.

Opsioni i katërt do të ishte thjesht të rifillohej me Universitetin e Mitrovicës në një lokacion tjetër. Pse jo? Personeli kompetent është në dispozicion dhe kryesisht është i gatshëm të vazhdojë punën në territorin e Kosovës. Për studentët potencialë, lokacioni mund edhe të mos jetë kriter themelor. Ajo që ata presin të fitojnë për parat e tyre janë diplomat e pranuar, infrastruktura e mirë dhe personeli kompetent. Kudoqoftë.

7. Kërkesat "e detyrueshme" për arsimin e lartë minoritar

S'do mend se korniza ligjore e Kosovës duhet të respektohet si shtylla kryesore e cilitdo institucion të arsimit të lartë në territorin e Kosovës. Ligji kosovar i arsimit të lartë duhet të zbatohet në tërësi, statuti i universitetit duhet t'i respektojë rregullat dhe duhet t'i përshtatet sistemit kosovar të licencimit, të sigurimit të cilësisë dhe të vlerësimit në arsimin e lartë.

E dyta, një universitet i tillë – thjesht për shkak të shpërputhjes ndërmjet shpenzimeve vjetore dhe përqindjes së studentëve potencialë – nuk do të mund të mbështetej vetëm në buxhetin e konsoliduar të Kosovës, por do të duhej të gjente donatorë privatë. Arsyet për të dhënë donacione do të mund të ishin të natyrës politike ose teknike. Dhe përsëri, universiteti duhet të jetë mjaftë atraktiv sa për të siguruar cilësi të qëndrueshme, përndryshe nuk do të mund të gjejë donatorë. Nga këndvështrimi politik, donatorë do të mund të ishin qeveritë e vendeve, studentët e të cilave do të vijonin studimet në këtë universitet. Në këtë rast do të duhej marrë në shqyrtim mundësinë e aplikimit të drejtës në veto për çështjet strategjike

për donatorët e tillë kryesorë.

E treta, kërkohet personel i mjaftueshëm dhe me përvojë në kompleksin universitar. Arsyet për një gjë të tillë janë shpjeguar më lartë. Në thelb, kërkohet personel me përvojë dhe kompetent, të cilët do të bënin të mundshme që institucioni të fillonte punën me një nivel të caktuar të cilësisë përkitazi me kriteret akademike dhe organizative.

Një gjë tjetër me rëndësi për t'u siguruar nga një institucion i tillë në kushtet e Kosovës është që të sigurohen shërbime të mjaftueshme për enklavat dhe komunat e tjera. Shërbimet e arsimit të lartë duhet të sigurohen për të gjithë studentët potencialë në gjuhët minoritare, të cilët janë të gatshëm të studiojnë, pa marrë parasysh vendqëndrimin e tyre në Kosovë. Edhe kjo i ka aspektet e veta organizacionale dhe politike.

E fundit, por jo për nga rëndësia, standardet evropiane duhet të zbatohen që nga fillimi, që do të mund të bënte që ky universitet të implementonte Bolonjën më shpejtë se sa Universiteti i Prishtinës. Kjo nuk do të ishte ndonjë zhvillim i keq, përderisa një konkurrencë e tillë të krijonte një sistem funksional të arsimit të lartë dhe nëse do t'i kontribuonte zhvillimit në të dyja anët.

8. Përse nuk duhet krijuar një version të përshtatur të Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL) të Tetovës?

Javëve të fundit, disa artikuj janë botuar lidhur me planin e mundshëm të Universitetit të Mitrovicës. Përderisa këto shkrime duhet parë para së gjithash në kontekstin e negociatave për statusin, ata megjithatë bartin një dozë të rrezikut pasi që propozojnë zgjidhje "të thjeshta", të cilat nuk i bëjnë ballë një analize të thelluar. Një nga këto koncepte rekomandon një version të përshtatur të Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL) të Tetovës.


Pas një shqyrtimi më të kujdesshëm të kushteve dhe të konceptit të dy universiteteve, konstatojmë këto aspekte shumë të ndryshme ndërmjet UEJL-së dhe UM-së:

- Tregu i konsumatorëve studentë në gjuhën minoritare është tepër i vogël për dy universitete njëri pranë tjetrit
- UEJL / Tetovë është një rrëfim i suksesit edhe për arsye se
- Janë investuar shuma të mëdha parash – të cilat nuk janë në dispozicion në rastin e Universitetit të Mitrovicës
- Universiteti i vjetër i Tetovës është mënjanuar gradualisht – ekzistenca paralele e UM-së dhe e një universiteti të dytë publik do të ngjallte konflikte serioze lidhur me vënien në dispozicion dhe ndarjen e personelit ekzistues akademik
- Një universitet cilësor kërkon personel cilësor në vendin ku e ka selinë; në këtë rast, ose të gjithë mësimdhënësit do të punonin në të dyja institucionet, ose eksperimenti do të dështonte
- Sistemi kosovar i arsimit të lartë privat – deri më tani – nuk është dalluar për ndonjë sukses; më parë mund të thuhet se i ka tejkaluar parashikimet më pesimiste
- Arsimi i lartë minoritar në Kosovë kërkon një zgjidhje teknike – jo zgjidhje politike; një ditë pas vendimit mbi statusin shumë ekspertë politik do të kenë shkuar, ndërsa problemet do të kenë mbetur të pazgjidhura.

9. Modeli i Hong Kongut

Figura 1: Funksionimi autonom i universitetit sipas Ligjit kosovar për Arsimin e Lartë

Qeverisja autonome universitare



“Modeli i Hong Kongut” ka një histori të thjeshtë. Ligji kosovar i arsimit të lartë është një ligj shumë modern. Ky i siguron universitetit një shkallë të lartë të funksionimit autonom. Figura 1 tregon se shigjeta e cila pothuajse është shlyer fare është ajo që tregon ndërveprimin në mes rektoratit dhe ministrisë. Këshilli drejtues merr mbi vete shumë përgjegjësi nga ministria, ndërveprimi i së cilës zhvendoset nga bashkëpunimi ditor në atë vjetor, përmes buxhetit të përgjithshëm dhe negociatave vjetore të buxhetit, të cilat ngritën mbi raportet vjetore të punës, si dhe në analiza dhe vlerësime strukturale. Ky koncept është shumë i dobishëm për rastin që po e shqyrtojmë sot, pasi që çfarëdo ndërveprimi i ngushtë ndërmjet universitetit dhe ministrisë përfshinë edhe aspektin politik. Sa më shumë distancë që të sigurojë institucioni nga ministria, aq më lehtë do të jetë të arrihen zgjidhje politike të cilat mund të implementohen në modele teknike.

Më poshtë paraqesim aspektet kryesore të këtij modeli:

- Korniza ligjore e Kosovës është e detyrueshme
- Statuti duhet të mbetet bazë primare operationale
- Kompetenca ligjore e statusit i takon qeverisë kosovare
- Kompetenca strategjike përkitazi me institucionin do të mund të ndahej ndërmjet donatorëve / kontribuuesve kryesorë financiarë
- Buxheti vjetor nxjerrët nga dy burimet kryesore
- Buxheti i Kosovës

- Donatorë qeveritarë / privatë
- Institucioni duhet të ketë statusin e një universiteti publik të Kosovës

10. Një vështrim skeptik ...

Kjo analizë përmbyllet me një vështrim timin skeptik sepse – nga aspekti teknik – situata e tanishme vazhdon të mbetet e rëndë. Në përgjithësi, kohët e politikës nuk janë kohë të mira për zgjidhje teknike. Në kohën përderisa gazetatat janë plotë me tituj mbi “tema të nxehta”, është vështirë të shtyhen përpara zgjidhje dhe diskutime për një zgjidhje të mirë. Është një situatë e ngjashme me atë që u krijua në Universitetin e Prishtinës prej se problemet e rektoratit u bënë publike.

Së dyti, nuk mund të themelohet plotësisht një institucion i arsimit të lartë për minoritetet për një muaj ose për një gjysmë viti. Kjo kërkon një shtytje të gjatë (strategjike dhe financiare), ndërkaq politikanët nuk e kanë as shtytjen strategjike, as sasi të madhe të fondeve, e as përkushtimin e nevojshëm. Kjo vetëm sa e shton problemin që – përkundër promovimit që ka prej politikanëve dhe prej ekspertëve – arsimit i lartë mbetet një segment shumë i vogël i shërbimeve publike, i cili u kushtohet një pjese të vogël të pjesëtarëve të shoqërisë.

Ajo që e shton skepticizmin tim është që Universiteti i Mitrovicës u bë gjithnjë e më shumë një kartë në lojën politike gjatë disa muajve të fundit. Ka brengosje të shumta se universiteti do të mund të sakrifikohej gjatë negociatave për statusin. Për këtë arsye i bëj thirrje opinionit publik dhe klasës politike kosovare që të vendosin në favor të Universitetit të Mitrovicës dhe në favor të pozitës së tij të ardhshme brenda Kosovës dhe, gjithsesi, përtej ekipit të përcudshëm të Papoviqit. Prapa Papoviqit ka shumë substancë akademike, shumë traditë dhe kompetencë akademike ka mbetur ende në këtë universitet. Nëse Papoviqi ikën një ditë – çfarë do të bëjë atëherë Kosova zyrtare? Ajo që brengos më shumë është se për shkak të izolimit dyvjeçar Universiteti i Mitrovicës po vuan një ikje substanciale të trurit të akademikëve kompetentë serbë nga Kosova.

Kjo sjell te një pyetje tjetër për klasën politike kosovare. A ka ndër ta një njeri i cili do të donte ta ndalonte këtë ikje të trurit? Kjo është një pyetje politike, por ajo ka një ndikim të fuqishëm teknik. Mbase është tërheqëse për një mësimdhënës akademik që të jap mësim dhe të kryej kërkime shkencore këtu në Kosovë. Sepse Kosova dëshiron të themelojë një institucion cilësor, jo vetëm një institucion sa për sy e faqe sa për të kaluar fazën e negociatave.

Unë e shoh si obligim të qeverisë kosovare dhe të publikut kosovar që t’u thotë këtyre njerëzve: “Ne jemi të interesuar për përvojën tuaj, ne na intereson kompetenca juaj, ju lutem qëndroni këtu. Ne duam t’ju japim juve një vizion, por ju duhet t’u bindeni rregullave. Ka një ardhmëri për ju në Kosovë”.

Një pyetje që nuk është adresuar asnjëherë deri më tani, bëhet gjithnjë e më urgjente në këtë kontekst. Cila është situata në tregun e punës në këtë moment për të diplomuarit joshqiptarë? Në parim universiteti do të duhej të “prodhonte” një të diplomuar me qëllim të plotësimit të një kërkesë të tregut të punës ashtu që ky i punësuar të fitojë një vend të mirë pune. Cilat janë kërkesat e tregut të punës? Kush do t’i angazhojë këta të diplomuar, kush do t’i paguajë të ardhurat e tyre? A do të punojnë ata vetëm si përkthyes të UNMIK-ut vetëm sepse kjo është paga më e lartë që mund të fitohet? Kjo nuk mund të jetë zgjidhje përfundimtare për të diplomuarit – as për ata të UM-së e as për ata të UP-së. Në të ardhmen do të duhet një ndërveprim shumë më domethënës ndërmjet tregut të punës dhe universiteteve të Prishtinës e të Mitrovicës për të identifikuar se ku do të duhej orientuar

profilin e tyre akademik.

Dhe në fund, jo edhe për nga rëndësia, mbetet një pyetje fundamentale – çka është me rëndësi? A është me rëndësi të jesh student apo të jesh i diplomuar? Nga përvoja ime në Kosovë, për shumicën më të rëndësishëm është statusi i studentit. Unë jam student dhe, së këndejmi, jam edhe anëtar i elitës së shoqërisë (gjë që është e vërtetë); kjo më ndihmon të gjejë punë të mira. Por, sa prej tyre janë të përkushtuar që të bëhen të diplomuar? Nuk e bëjnë këtë mbase, për arsye se nuk ka treg të punës për ta.

Prandaj, kjo do të jetë pyetja themelore për fjalinë e misionit për universitetet e Kosovës: . A ekzistoj unë që të siguroj një kazan për studentët apo unë duhet t'i ndihmoj ata që të përfundojnë studimet? Këto janë pyetje shumë politike, të cilat do të duhet të diskutohen në muajt që po vijnë, me qëllim që të përqendrohemi pastaj në aspektet teknike të sistemit të arsimit të lartë në Kosovë, të nxjerrë nga përgjigjet në pyetjet e mësipërme.

Nevoja, dëshira dhe përkushtimi i qeverisë kosovare për të siguruar arsim të lartë për minoritetet do të kushtojë të holla, do të marrë ca kohë dhe do të kërkojë një qasje më pragmatike ndaj Mitrovicës se më parë, duke u nisur nga fakti se personeli akademik është atje, është i gatshëm të qëndrojë në Kosovë dhe përfaqëson kompetencën akademike


Ëndrra për arsimim shumetnik – trillim dhe realitet në arsimin e lartë në Kosovën e sotme

Dukagjin Pupovci
Qendra për Arsim e Kosovës

Unë e kam titulluar prezantimin tim “Ëndrra për arsimim shumetnik, trillim dhe realitet në arsimin e lartë në Kosovën e sotme”, dhe e kam paramenduar që të jetë pak a shumë si një lloj reagimi, si një lloj inputi ndaj diskutimit të z.Woeber. Së pari të gjithë e dimë se përfundimi i luftës në Kosovë, na ka pritur me dy universitete, të cilat faktikisht mbanin të njëjtin emër: “Universiteti i Prishtinës”. Edhe pse këto dy universitete, për mëse 20 vjet kanë funksionuar si një organizëm i vetëm, megjithatë në fillim të viteve të nëntëdhjeta Universiteti i Prishtinës është shfrytëzuar si terren për demonstrimin e forcës. E dimë të gjithë se si përfundoi gjithë kjo, pra një pjesë e Universitetit të Prishtinës atëherë e filloi luftën për mbijetesë në kushte abnormale dhe duke pritur ditët kur situata do të normalizohej. Ndërkaq, pjesa tjetër e asaj që quhej Universiteti i Prishtinës shtirej se çdo gjë është duke funksionuar mirë dhe injoronte plotësisht nevojat e shumicës. Në këto tetë vite, të mbijetesës të asaj që e quajmë Universiteti i Prishtinës, identiteti shumetnik i Universitetit të Prishtinës i trashëguar nga koha e mëparshme u nda në identitete të veçanta të cilat më nuk kishin nevojë për njëri tjetrin. Periudha e pasluftës na solli një realitet të ri. Derisa njëri universitet bënte përpjekje ti adaptohej punës në kushte normale pas tetë vjet ekzili dhe tetë vjet deprivimi nga çdo gjë që ishte normale, tjetri filloi me improvizime akademike duke refuzuar të ballafaqohet me realitetin e ri. Edhe një herë, arsimi u instrumentalizua nga politika, e cila kishte një qëllim të qartë - të pengojë procesin e pavarësimit të Kosovës. Sipas mendimit tim, realiteti i sotëm është se jemi në pritje të një vendimi për statusin politik të Kosovës, prandaj duhet të tregojmë një shkallë të lartë të përgjegjësisë qytetare dhe shoqërore si dhe një shkallë të lartë të mirëkuptimit për nevojat e bashkëqytetarëve tonë që nuk e flasin gjuhën e shumicës. Vetëm kështu mund ta ndërtojmë një shoqëri të re dhe demokratike, dhe në të cilën do të ketë vend për të gjithë ata të cilët jetojnë në të, një shoqëri që mund të bëhet pjesë e integriteteve evropiane dhe rajonale. Strategjia e arsimit të lartë për periudhën 2005-2015 e ka të definuar një vizion dhe një mision. Vizioni i kësaj shoqërie është “Kosova një shoqëri demokratike e integruar në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, ku dija dhe kërkimi shkencor janë në funksion të zhvillimit shkencor, kulturor, shoqëror dhe ekonomik”. Kështu e sheh strategjia e arsimit të lartë Kosovën në vitin 2015. Kuptohet, për të arritur një Kosovë të tillë arsimi i lartë duhet ta ketë një mision të vetin të cilin do të mund ta ushtroj gjatë kësaj periudhe. Këtu pra parashihet të ndërtohet një sistem i efektshëm i arsimit të lartë i cili do t'i kontribuonte ngritjes së mirëqenies së shoqërisë duke i ofruar mundësi të barabarta për të gjithë. Fjala mundësi të barabarta është këtu një fjalë kyçe, e cila gjithnjë duhet pasur parasysh. Arsimi i lartë në Kosovë tradicionalisht ka qenë promotor i zhvillimit kulturor, shoqëror dhe ekonomik të vendit, por në kohën e sotme kjo nuk mund të provohet vetëm me numrin e të diplomuarve, të magjistruarve dhe të doktoruarve. Në Kosovën e pasluftës ne faktikisht jemi duke e ndërtuar një sistem të ri arsimor, i cili duhet t'i kontribuojë ndërtimit të një administrate publike të përgjegjshme, ndërtimit të një shoqërie të informatizuar. Pra, ky arsim, ky nivel i arsimit ka përgjegjësi të veçantë për arsimimin e kuadrove në pajtim me nevojat e shoqërisë. Gjithashtu, nuk duhet të harrojmë se ka përgjegjësi për ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët. Me këtë strategji të arsimit të lartë dhe me ligjet në fuqi institucionet e Kosovës kanë marrë mbi vete disa obligime të caktuara. Në radhë të parë obligime ndaj qytetarëve të vet, por edhe obligime ndaj bashkësisë ndërkombëtare.

2. Gjendja ekzistuese


Do ta shfrytëzoj këtë strukturë për ta bërë një analizë të thjeshtë të sistemit të arsimit të lartë, e cila, besoj, do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë ndërlidhjen në mes të burimeve ose inputeve pra asaj që ne investojmë në sistemin e arsimit të lartë dhe efekteve të dëshiruara të këtij sistemi.




2.1. Efektet dhe rezultatet e pritura

Pra, unë do të përpiqem të nisem nga një situatë relativisht e idealizuar se çfarë efekte do të kishim dashur që sistemi i arsimit të lartë të prodhojë në shoqërinë tonë nga aspekti i përfshirjes së të gjithëve, e pastaj të shohim se çfarë do të duhet të bënim që të arrihen efektet e dëshiruara. Pra, pika e parë e cila duhet të kihet parasysh këtu është se shoqëria duhet të jetë në gjendje t'i shfrytëzojë burimet njerëzore dhe t'i shfrytëzojë të arriturat shkencore me qëllim të zhvillimit të përsheptuar kulturor, ekonomik dhe shoqëror. Shoqëria duhet të pranojë se njerëzit janë pasuria më e madhe që ka dhe duhet t'i kushtojë kujdes të veçantë zhvillimit të burimeve njerëzore. Në kontekstin tonë kjo duhet të shihet edhe nga këndvështrimi i zvogëlimit të problemit të papunësisë e cila zyrtarisht në Kosovë arrin shifrën prej 40% të popullatës aktive. Tani e kemi edhe një sfidë tjetër, se në tregun e punës në Kosovë çdo vit vijnë 20-25 mijë punëkërkues të rinj, të cilët, faktikisht, lehtë mund të shndërrohen në probleme sociale. Prandaj, sistemi i arsimit të lartë ka përgjegjësi të veçantë që të sigurojë punësimin e qytetarëve dhe të sigurojë një shkallë më të lartë të mobilitetit të fuqisë punëtore, pra të bëjë të mundur që fuqia punëtore të jetë në gjendje të lëvizë edhe në vende të tjera të rajonit dhe Evropës, në kërkim të punës. Mirëpo, të jetë në gjendje edhe të kërkojë punë për vete dhe për të tjerët. Pra, këtu roli i sistemit të arsimit të lartë është vërtetë crucial. Nga cilësia e burimeve njerëzore, nga cilësia e shkathtësive, dhe e njohurive varet edhe mundësia për tërheqjen e investimeve të huaja. Pra, në kushtet e konkurrencës, kur vendet e ndryshme të Ballkanit Perëndimor si rajon dhe Evropës Juglindore pak më gjerë, ofrojnë komoditete të ndryshme për investitorë të huaj. Me siguri se njëri ndër faktorët kyç është edhe shkalla e zhvillimit të burimeve njerëzore. Për të arritur një shkallë të tillë të burimeve njerëzore, përsëri përgjegjësia i bie sistemit të arsimit të lartë. Dhe diçka që i

kemi premtuar vetvetes dhe bashkësisë ndërkombëtare është tendenca e ndërtimit të një shoqërie demokratike dhe tolerante ku po ashtu sistemi i arsimit të lartë duhet ta ketë rolin e vet, sepse sistemi i arsimit të lartë përveç njohurive, shkathtësive praktike duhet ta zhvillojë edhe kulturën që ata të jenë në gjendje të bashkëjetojnë në një shoqëri demokratike dhe ta kultivojnë vazhdimisht frymën e tolerancës. Këto janë pra disa efekte të dëshiruara të cilat do të kishim dashur t'i shohim si rezultat i funksionimit të sistemit tonë të arsimit të lartë.




arsimit të lartë duhet t'iu mundësojë qytetarëve që të fitojnë shkathtësi që korrespondojnë me nevojat e tregut të punës. Në kohët e sotme dinamika e ndryshimit të kërkesave në tregun e punës është vërtetë shumë e shpejtë. Ato kërkesa ndryshojnë prej ditës në ditë dhe qytetarët duhet të jenë në gjendje t'i adaptohen kërkesave të tilla. Një mënyrë se si i adaptohen kërkesave të tilla është mësimi ose të nxëniet gjatë gjithë jetës si njëri ndër shtyllat e procesit të Bolonjës. Pra në këtë formë qytetarët arrijnë që t'i adaptohen kërkesave dhe arrijnë t'i adresojnë problemet e tyre të përditshme. Në nivelin e universitetit, respektivisht arsimit të lartë, kjo do të thotë edhe kapaciteti i shtuar për pjesëmarrje në programe të shkëmbimit akademik si në nivelin rajonal ashtu edhe në nivelin ndërkombëtar. Nga sistemi i arsimit të lartë pritet të prodhojë njerëz të cilët janë në gjendje të marrin pjesë në programe të tilla të shkëmbimit akademik të cilët janë në gjendje të krijojnë në shkencë, në mënyrë që të mund të bashkëpunojnë me të tjerët që këto dije t'i thellojnë, respektivisht t'i shpërndajnë në rajone të caktuara. Bashkëpunimi i tillë, sidomos në nivelin rajonal, do të ndihmojë sigurisht shumë në afrimin e komuniteteve edhe brenda vet Kosovës. Dhe një gjë që është me rëndësi për shoqëritë shumetnike si Kosova, është aftësia për menaxhimin e diversiteteve në shoqëri, pra, ne jemi një shoqëri me diversitete sikurse edhe shumë shoqëri të tjera dhe në periudhën e pasluftës jemi duke mësuar se si të menaxhojmë këto diversitete. Sistemi i arsimit të lartë mund t'i kontribuojë jashtëzakonisht shumë rritjes së aftësisë së shoqërisë për t'i menaxhuar diversitetet e tilla me çka faktikisht do të minimizoheshin edhe probleme të cilat ekzistojnë në mes të komuniteteve të ndryshme dhe tensionet që mund të jenë rezultat i së kaluarës ose rezultat i veprimeve të tanishme politike.





2.2. Strukturat dhe proceset

E tani shihet nga kjo strukturë se rezultatet kushtëzohen nga strukturat dhe proceset, pikërisht nga bashkëveprimi i strukturave dhe proceseve, prandaj është rendi t'i analizojmë pak strukturat që i kemi në fuqi në rastin e Kosovës dhe që kanë të bëjnë me arsimin e lartë, veçanërisht në rastin e minoriteteve. Së pari, korniza ligjore për arsimin e lartë në Kosovë, siç tha edhe parafolësi, bazohet plotësisht në parimet e Procesit të Bolonjës. Është një kornizë ligjore vërtet bashkëkohore e cila mund të krahasohet me kornizat ligjore të vendeve të tjera evropiane. Kjo kornizë ligjore e përcakton edhe obligimin e institucioneve të Kosovës që të përkujdesen për respektimin e të drejtave të të gjitha komuniteteve, por të përkujdesen edhe për zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë. Kjo kornizë ligjore ofron një shkallë mjaft të lartë të autonomisë për të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, prandaj unë konsideroj se është një kornizë ligjore e volitshme edhe për organizimin e arsimit të lartë në gjuhët e minoriteteve ose për nevojat e minoriteteve. Unë nuk mendoj që korniza ligjore është pengesë për minoritetet që të marrin pjesë në arsimin e lartë. Kjo kornizë ligjore parasheh një mënyrë të tillë të ndarjes së kompetencave dhe përgjegjësisë që universiteteve, respektivisht institucioneve publike të arsimit të lartë, iu mbetet pothuajse e tërë kompetenca që në kuadrin e tyre të vendosin për programe të studimeve, për çështje akademike, bile në masë të madhe edhe për çështjet e financimit. Ndërsa, për institucionet private, të mos flasim sepse ato kanë kompetencë të plotë për menaxhimin e programeve dhe aseteve të tyre. Pastaj, kjo kornizë ligjore është e favorshme sepse bën të mundur që institucionet e arsimit të lartë të vendosin për rrjetin e njësive akademike brenda institucionit, si dhe lejon mundësinë që të themelohet një numër më i madh i institucioneve të arsimit të lartë publik, në varësi nga nevoja që mund t'i kenë njerëzit, respektivisht pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme. D.m.th mendimi im është se ne kemi një kornizë ligjore, kemi ca struktura të cilat janë të volitshme për realizimin e programeve që do t'i përmbushnin nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve.



Pastaj kemi proceset, prej të cilave kisha veçuar këtë punën e gjuhës mësimore. Ne në Kosovë kemi një traditë mjaft të gjatë të mësimdhënies në gjuhët e komuniteteve të ndryshme dhe ndonjëherë na duket e pazakonshme të tejkalohej ato tradita të së kaluarës, dhe që komunitetet e ndryshme faktikisht të përpiqen të kenë ndonjëherë mësimdhënie edhe në ndonjëherë prej gjuhëve. Po kjo është sigurisht diçka që do ta kemi parasysh edhe pasi që t'i dëgjojmë përvojat që do t'i sjellin mysafirët nga vendet e tjera. Përveç kësaj, proceset që i kemi në sistemin tonë të arsimit të lartë përbëhen edhe nga metodat e mësimdhënies që janë pak a shumë metoda të përbashkëta dhe që nuk varen nga gjuha mësimore, por një sistem i cili ia vlen t'i kushtohet kujdes pak më shumë është mundësia e transferimit të krediteve prej një institucioni në institucionin tjetër, gjë që bën të mundur që pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme, ose më mirë të them studentët, të fitojnë kredite të caktuara në institucione të ndryshme të arsimit të lartë dhe të jenë në gjendje që ato kredite, respektivisht provime të dhëna, t'i bartin në institucione tjera. Kuptohet, ne synojmë që sisteme të tilla të funksionojnë jo vetëm në nivel të vendit, por të funksionojnë edhe në nivelin e rajonit dhe Evropës, gjë që, pa dyshim, do të bëjë të mundur lëvizshmërinë e të gjithë studentëve dhe tejkalimin e barrierave etnike dhe gjuhësore për të gjithë. Tek proceset duhet të përmendet edhe një fakt të cilit iu referua edhe parafolësi, e që ka të bëjë me sigurimin e cilësisë. Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë është një ndër shtyllat e Bolonjës dhe, vërtet, pa sigurim të cilësisë është e kotë që të bëhen oferta, d.m.th për organizimin e mësimin ose ofrimin e shërbimeve të arsimit të lartë në gjuhët, qoftë të komuniteteve ose shumicës. Cilësia është mbi të gjitha dhe çdo gjë që nuk e merr parasysh cilësinë do të ishte, thjesht, një improvizim.



2.3. Burimet (inputet) e sistemit

Tani erdhëm deri të kjo shkalla, si të them, më e ulët e kësaj strukture, që janë burimet ose inputet të cilat i ushqejnë në një mënyrë proceset edhe strukturat. Unë mendoj se inputi kryesor, burimi kryesor që i nevojitet shoqërisë sonë është vullneti i mirë për integrim. Mendoj se tek institucionet e Kosovës ekziston një vullnet i mirë për t'i integruar pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në një shoqëri demokratike kosovare, e shpresoj që shumë shpejt do të tejkalohen edhe disa pengesa politike të pjesëtarët e disa komuniteteve që të jenë pak më aktiv në procesin e integritimit. Pa vullnet të mirë për integrim është e pamundur që të ofrohen shërbime, sepse askujt nuk do të mund t'i ofrohen shërbime sado të mira dhe të volitshme ato qofshin, nëse ai person, ai grup ose komunitet, shërbimet e tilla nuk i do. Ne tani në Kosovë jemi në një situatë ku arsimi është instrumentalizuar në një masë të madhe nga politika dhe, faktikisht, është shumë vështirë për momentin të zgjidhen disa çështje të karakterit teknik, siç tha edhe parafolësi, kur kemi çështje politike të cila janë duke u diskutuar në mes të institucioneve të Kosovës, dhe në rastin konkret, institucioneve të Serbisë. Tjetër, nevojiten njerëzit të cilët kanë vizion, njohuri, dhe motiv dhe të cilët janë të përgatitur për ndryshime. Unë mendoj se njerëzit e tillë në Kosovë i kemi, vetëm duhet që ata njerëz të vijnë në shprehje. d.m.th këtu kërkohet që të jemi me mendje të hapur në pjesëtarët e të gjitha komuniteteve, në mënyrë që t'i kuptojmë mirë nevojat, posaçërisht të komuniteteve pakicë në këtë rast, dhe të kontribuojmë që ato nevoja të përmbushen. Dhe një problem i cili mbetet gjithnjë akut edhe në ato shoqëri që janë shumë të pasura – por që te ne është problem posaçërisht i pranishëm - është çështja e burimeve materiale të cilat në rastin tonë nuk janë të mjaftueshme. Unë do t'iu referohem edhe pak burimeve materiale gjatë tre katër minutave të ardhshme, prandaj, në këtë moment do ta lë vetëm me konstatimin se burimet materiale nuk janë të mjaftueshme, të paktën jo për të ofruar një shërbim cilësor për të gjithë.

3. Çfarë mund t'u ofrojë Kosova minoriteteve?

Në radhë të parë duke u nisur nga tradita që kemi, duke u nisur nga tolerance të cilën gjithnjë jemi përpjekur që ta kultivojmë në Kosovë, mendoj se Kosova duhet t'iu ofrojë minoriteteve financimin e një universiteti publik me mësim në gjuhën serbe dhe boshnjake. Kjo është diçka që tani ekziston, edhe pse ekziston ndoshta në një mënyrë që në këtë çështje është ngatërruar politika, megjithatë, është diçka që duhet të sigurohet për këto komunitete me një afat më të gjatë. Natyrisht, unë aspak nuk po përpiqem që në këtë rast t'i neglizhojë nevojat e komuniteteve tjera, mirëpo në mënyrë specifike mendoj se e kemi borxh si Kosovë të ofrojmë shërbime të arsimit të lartë në këto gjuhë ku kemi praninë më të madhe të komuniteteve. Kuptohet, unë mendoj se duhet të kemi parasysh edhe pjesëtarët e grupeve të tjera gjuhësore, siç janë p.sh. turqit, të cilëve duhet të iu ofrojmë mundësi për shkollim në gjuhën amtare sa herë që kjo është e mundur dhe e dëshirueshme. Pastaj, duhet ofruar edhe mundësinë për transferim të krediteve nga universitete të tjera në Kosovë, d.m.th pjesëtarët e komuniteteve tjera gjithnjë duhet të kenë mundësi të kryejnë pjesë të caktuar të studimeve në universitete tjera, ashtu sikurse edhe pjesëtarët e komunitetit shumicë që duhet të kenë qasje në këtë që unë po e quaj universitet publik në gjuhën serbe dhe boshnjake, pa dashur të paragjykoj a duhet të jetë ky një universitet si pjesë e Universitetit të Prishtinës apo do të duhej të jetë një universitet i veçantë. Është me rëndësi që Kosova t'i inkurajojë programet ndërkombëtare të studimit në universitetet e Kosovës. Pra, në kohën e sotme të globalizimit është shumë e zakonshme që në universitetet e Kosovës të organizohen programe studimi p.sh në gjuhën angleze ose në gjuhë tjera të huaja, që është një mundësi shtesë për sigurimin e bashkëjetesës në mes të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme. Programe në gjuhën angleze tani më kemi në shumë vende të Unionit Evropian të cilat nuk e kanë gjuhën angleze si gjuhë zyrtare, por kjo thjesht bëhet për shkak të tendencave të globalizimit e që janë të pranishme posaçërisht në fushën e arsimit të lartë. Ne kemi partneritete të universiteteve të Kosovës me universitetet evropiane, por kemi shumë pak partneritete në nivel të rajonit. Mendoj se një gjë që duhet të bëhet është të

inkurajohen partneritetet në mes të universiteteve të rajonit, sepse përmes këmbimit të mësimdhënësve dhe të studentëve, besoj që, ne do të arrijmë të njihemi më mirë me universitetet që i kemi brenda rajonit dhe do të arrijmë që t'i tejkalojmë disa barrierat të cilat janë të karakterit politik ose të ndonjë karakteri tjetër, e që në shumtën e rasteve bazohen në paragjykimet. Po ashtu, universitetet e rajonit, apo të them më mirë institucionet e arsimit të lartë në rajon, kanë shumë çështje të përbashkëta të cilat mund t'i trajtojnë së bashku përmes projekteve të përbashkëta hulumtuese, përmes organizimit të konferencave të përbashkëta, këmbimit të studentëve dhe mësimdhënësve e kështu me radhë. Natyrisht, në këtë rrugë neve na presin edhe sfida të shumta; sfidë e parë janë vështirësitë evidente për integrimin e komunitetit serb në shoqërinë kosovare, e të cilat kanë të bëjnë shumë pak me arsimin e lartë. Për tejkalimin e këtyre vështirësive do të nevojitet shumë vullnet politik edhe me siguri që do të nevojitet edhe një kontribut i madh i bashkësisë ndërkombëtare. Pastaj, në Kosovë realiteti është se mundësitë buxhetore i kemi shumë të kufizuara - Kosova ka shpenzimet më të ulëta publike për arsim në rajon - dhe këtu vetëm ta nxjerr faktin se gjatë hartimit të strategjisë së lartë e kemi bërë një vlerësim të shpenzimeve për nevojat e reformës së sistemit të arsimit të lartë në periudhën 2005-2010. Është fakt se për këtë periudhë Kosovës i nevojiten përafërsisht rreth 32 milionë Euro në vit vetëm nga buxheti, për dallim nga shifra e tanishme që është diku 16 milionë Euro në vit. Domethënë, llogaritjet tregojnë se investimi në sistemin e arsimit të lartë duhet të dyfishohet dhe duhet të arrijë diku 1.22% të bruto produktit vendor të Kosovës. Besoj se kjo sfida është mjaft e madhe për Kosovën dhe nuk ka të bëjë vetëm me integrimin e komuniteteve në sistemin e arsimit të lartë, por ka të bëjë me përmbushjen e obligimeve që dalin nga deklaratat e Bolonjës. Pra ne synojmë që vitin e ardhshëm me rregullimin e statusit politik, Kosova t'i bashkëngjitet procesit të Bolonjës dhe kjo bashkëngjitje e procesit të Bolonjës do të kërkojë nga ne që deri në vitin 2010 t'i plotësojmë disa kushte të caktuara dhe kjo është arsyeja pse investimet janë vlerësuar në këtë mënyrë. Pastaj, një kufizim tjetër që e kemi për momentin është njohja e kufizuar e gjuhës së mjedisit, veçanërisht të rinjtë. Këtu e kam fjalën për të gjithë rinjtë, e sidomos të komuniteteve pakicë, që është fakt se shumë pak e njohin gjuhën shqipe dhe shumë pak i njohin gjuhët tjera të mjedisit, gjë që vështirëson integrimin e tyre në sistemin kosovar të arsimit të lartë. Por, edhe mosnjohja e gjuhëve të mjedisit nga ana e rinisë shqiptare është po ashtu një problem i cili duhet pasur parasysh. Partneritetet brenda rajonit, siç thashë edhe më parë, janë pothuaj inekzistente; ende ekzistojnë paragjykimet të shumta për partneritete të tilla dhe njerëzit shumë më me dëshirë nga universitetet e rajonit hyjnë në partneritete me universitetet evropiane të cilat janë larg nga rajoni, të cilat qoftë edhe nuk i njohin fare, se sa që hyjnë në partneritete me njëri tjetrin. Një sfida, që besoj se neve do të na përcjellë gjatë këtyre përpjekjeve tona për integrimin e të gjitha komuniteteve në sistemin e arsimit të lartë, është edhe nevoja për hapërim drejt integritimeve evropiane. Paralel me këtë ne duhet t'i plotësojmë edhe ato kushtet për të cilat sapo fola, siç janë: sigurimi i cilësisë, funksionalizimi i sistemit të kredive, e kështu me radhë, gjëra të cilat do të kërkojnë edhe më shumë investime edhe më shumë kohë dhe mund nga ana e institucioneve tona dhe të gjitha këto duhet të bëhen paralel. Në fund, më mbetet që të ju falënderoj për vëmendjen.

Përgjegjësitë e bashkësisë ndërkombëtare për arsimin e lartë për minoritetet – një ditë pas vendimit për statusin

Alexander Bayerl

Shef i Zyrës Ndërlidhëse të Austrisë në Prishtinë

Më lejoni të falënderoj Forumin 2015, Fondacionin Soros dhe të gjithë përfaqësuesit e tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët ndihmuan në organizimin e kësaj konference, sepse mendoj se kjo është një iniciativë shumë e rëndësishme. Unë jam shefi i zyrës austriake - momentalisht dhe deri në fund të gjysmës së parë të vitit 2006, Austria mban presidencën e Bashkimit Evropian - kështu që unë jam këtu në rol të dyfishtë: si funksionar i Bashkimit Evropian dhe, në të njëjtën kohë, edhe në funksionin tim themelor si shef i pranisë austriake këtu prej vitit 2003.

Gjatë këtyre tre vjetëve e kam përcjellë me vëmendje fushën e arsimit të lartë dhe kjo fushë ka qenë vazhdimisht në fokus të punës së zyrës sonë. Tash më lejoni t'i kthehem pak titullit "Përgjegjësitë e bashkësisë ndërkombëtare për arsimin e lartë të pakicave në Kosovë"; kjo është një çështje e ndërlikuar, dhe nuk është e lehtë për mua të mbulojë tërë këtë spektër tematik, sepse kur flasim për komunitetet ose minoritetet ne hasim edhe në një shumësi etnash në komunitetin ndërkombëtarë në Kosovë.

Kemi këtu të pranishëm një përfaqësues të Zyrës Turke; në Kosovë ka një bashkësi të madhe dhe të rëndësishme turke në Kosovë, të cilët vijnë që nga koha e pushtimit shekullor turk mbi Kosovën, kemi boshnjakët, në rajonin rreth Janjevës kemi bashkësinë minoritare kroate, kemi goranët, e të tjerë, të mos përmend familjen rome të grupeve etnike, egjiptasit etj. Pra, kemi një spektër të gjerë të bashkësive etnike në Kosovë, të cilat janë të gjitha shumë të rëndësishme për arsimin e lartë në Kosovë. Megjithatë, do ti kthehem tash çështjes së serbëve të Kosovës për shkak të aspektit politik.

Arsimi ka qenë në qendër të vëmendjes në vitet e tetëdhjeta dhe të nëntëdhjeta. Me siguri e mbani mend mirë se pas heqjes së autonomisë krahinës së Kosovës, universiteti dhe sektori i arsimit të lartë kishin mbetur pikë qendrore e rezistencës së shqiptarëve të Kosovës kundër shtypjes së Sllobodan Millosheviqit. Rrënjët e LDK-së, partisë më të fuqishme në sistemin politik të Kosovës, lidhen me lidhjet e Presidentit Rugova me universitetin. Arsimi gjithnjë ka qenë në qendër të vëmendjes së shoqërisë kosovare dhe strumbullari i rezistencës kundër regjimit. Të njëjtën gjë dhe për të njëjtin qëllim e kemi parë në përkeqësimin e situatës në Universitetin e Mitrovicës ku Z. Papoviq tash shërben si rektor i kundërligjshëm i Universitetit të Mitrovicës.

T'i kthehem fakteve për realitetin demografik. Në të kaluarën, më saktë në vitet e tetëdhjeta kishte një numër të konsiderueshëm të serbëve të Kosovës dhe, siç e dini, ishte pikërisht rënia graduale e numrit të tyre që përbënte një nga motivet e Millosheviqit për t'i hyrë planit nacionalist. Prej 196.000 serbëve të Kosovës, të numëruar në regjistrimin e popullatës të vitit 1981, një numër i konsiderueshëm iku me vetëdije pas intervenimit të NATO-së në vitin

1999. Nuk është e lehtë të vlerësohet numri i tanishëm i serbëve të Kosovës që kanë mbetur të jetojnë këtu. Sipas disa statistikave dhe përlogaritjeve, numri prej 120-130.000 serbëve duket më realist, megjithëse mund të ketë pak më shumë se kaq. Kështu, konstatojmë se ka një bashkësi e rëndësishme serbe, e cila pos fuqisë së vet relative demografike ndaj bashkësive dhe minoriteteve të tjera, ka edhe përparësinë (së paku në veri) të një vendosjeje më koherente në tri komunat e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut, si dhe natyrisht, në pjesën e ndarë nga komuna e Mitrovicës.

Në fushën e universitetit kishte ndryshime të shpeshta, së pari nga Millosheviqi në fillim të viteve nëntëdhjetë dhe pastaj pas intervenimit të NATO-s në vitin 1999, kur strukturat universitare u zhvendosen nga Prishtina për në veri. Krahasuar me përvojat austriake, kjo më kujton fatin e universitetit gjerman në Pragë – Universitetit të Karllit. Pas vitit 1999 kishim dy universitete që pretendonin të njëjtin emër, por si institucion i dyfishtë. Pas intervenimit të NATO-s, Universiteti i Prishtinës, së bashku me dokumentacionin dhe me personelin udhëheqës lëvizën për t'u vendosur në veri. Kështu, nga këndvështrimi i serbëve të Kosovës tani kemi dy Universitete të Prishtinës. Kuptohet që ne nuk e pranojmë këtë dhe, universitetin në veri e quajmë Universiteti i Mitrovicës. Universiteti i Mitrovicës ishte në qendër të vëmendjes, sepse mendonim se kjo krizë fundamentale në fushën e arsimit duhej zgjidhur dhe se ne duhej ndihmuar që të arrihej mirëkuptimi. Të dyja institucionet, pa marrë parasysh pretendimet e tyre se përfaqësojnë institucionin dhe të vërtetën e mirëfilltë, do të duhej të integroheshin në procesin arsimor evropian.

Përse jemi angazhuar kaq shumë në këtë drejtim? Për arsien e thjeshtë se Austria që nga fillimi ka menduar se pajtimi dhe skemat konstruktive integruese të serbëve të Kosovës do të ishin kyçe për të ardhmen e tërë Kosovës. Arsimi do të jetë në qendër, sidomos nëse merren para sysh trendet demografike ndër serbët e Kosovës; këto rrjedha e bëjnë plotësisht të qartë, nga pikëvështrimi ndërkombëtar, se nuk bën të mos u ofrohen serbëve të Kosovës skema konstruktive të arsimit të lartë. Në rast të kundërt ata doemos do të jenë të detyruar të emigrojnë në universitete të tjera serbe. Në rend të parë ata do të largohen në Universitetin e Nishit, dhe në atë të Beogradit. Prandaj, nëse nuk investojmë në rininë dhe nëse nuk u japim atyre një perspektivë në universitetin e tyre në Mitrovicë, atëherë do të jetë shumë vështirë të ndalen të rinjtë. Mund ta merrni vetë me mend, nëse jeni një 18 ose 19 vjeçar dhe nëse do të emigronit për 5 ose 6 vjet në Beograd, gjasat për t'u kthyer në Kosovë janë shumë të vogla, sidomos në dritën e ndryshimeve politike dhe të vështirësive të serbëve kosovarë për t'u pajtuar me gjërat që kanë ndodhur prej vitit 1991.

Për këtë arsye investimi në strukturat e arsimit të lartë për serbët e Kosovës është edhe investim në të ardhmen e tyre. Për fat të keq zhvillimi i Universitetit të Mitrovicës ishte një proces shumë i ndërlikuar, ndërsa në dy vitet e fundit shumë negativ. Z. Weber, ulur djathtas prej meje dhe i angazhuar nga Agjencioni Austriak për Zhvillim (i cili është i përfaqësuar nga Z. Fric, ulur në skajin tjetër të tavolinës), ka punuar shumë në veri, për disa vite, pa ndihmën e askujt për reformimin e Universitetit të Mitrovicës dhe duke disenjuar skema të ndryshme reformuese. Në atë kohë kishim shënuar pak sukses, por për fat të keq më duhet të ju them se përfaqësuesi i UNMIK-ut i asaj kohe nuk kishte mirëkuptim për këtë dosje dhe këtë më duhet ta përmend me një dozë kritikizmi, duke shtuar se komuniteti ndërkombëtar deri vonë nuk kishte mirëkuptimin e duhur për çështjen e arsimit të lartë. Nganjëherë mbetem pa mend kur kujtoj shumtën e hollave që derdhen në të gjitha anët dhe për çfarëdo projektesh e nismash. Gjithmonë jam pyetur përse arsimit të lartë i jepej aq pak rëndësi, sidomos duke pasur parasysh trendet demografike të shqiptarëve dhe të serbëve të Kosovës, dhe në veçanti gjendjen ekonomike në Kosovë. Po të shikohet perspektiva ekonomike dhe problemet e stërmëdha ekonomike, mendoj se përgjigjja e vetme e qëndrueshme qëndron në investimin në arsim, sepse pa arsim të lartë nuk mund të ketë përparim në ekonomi. Për këtë arsye, për mua ka qenë plotësisht e pakuptimtë se si bashkësia ndërkombëtare nuk i ka kushtuar kujdes të duhur fushës së arsimit të lartë.

Mirëpo, nëse e shikojmë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe, nëse kërkojmë obligimet e bashkësisë ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë, nuk do të gjejmë ndonjë recetë të detajuar për arsien e thjeshtë se Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit - e cila është dokumenti kryesor dhe vendimtar i pranisë ndërkombëtare, i pranisë së UNMIK-ut në Kosovë - në të vërtetë është një dokument jo shumë i dobishëm orientues për problemet me të cilat ballafaqohemi ne sot. Kjo rezolutë ishte hartuar në vitin 1999 me pas dështimit të Konferencës së Rambujesë; kjo ishte hartuar po ashtu me prapavijën specifike të politikës shkatërrimtare të spastrimit etnik të Sllobodan Millosheviqit dhe me 800.000 deri 1 milion shqiptarë të Kosovës të detyruar të emigrojnë pas shkeljeve kolosale të të drejtave të njeriut dhe, përfundimisht, në kontekstin dhe nevojën specifike për zgjidhjen e konfliktit.

Tani, nuk jemi më në gjendje kur duhet zgjidhur konflikti siç ishim në vitin 1999. Ajo që na duhet sot është përqendrimi i komunitetit ndërkombëtar, por jo më në kërkesa sikur ato të 1- qershorit të vitit 1999. Dhe tash kur kujtoj PSSP-në e parë Kushner, pastaj Hakerupin dhe Shtajnerin, mendoj se atyre u mungonte mirëkuptimi i duhur për domosdonë e investimit në arsim të lartë. Problemet u ishin të njohura disa ekspertëve, por u injoruan nga ana e pjesës më të madhe të udhëheqjes politike. Ishte kjo një gabim fundamental i bashkësisë ndërkombëtare të pranishme në Kosovë. Me kalimin e kohës, kjo ndryshoi paksa me ardhjen e Mihael Shtajnerit dhe me këmbënguljen e tij në çështjen e Mitrovicës. Disa përpjekje të qëlluara, si për shembull, zhvendosja e selisë së UNMIK-ut me qëllim të dhënies së një nxitjeje simbolike problemit të Mitrovicës. Mihael Shtajneri ishte mbase i pari që u kujdes edhe për fushën e arsimit, por në atë fazë ishte shumë vonë; kjo më kujtohet pasi që pikërisht në atë kohë unë arrita në Kosovë si përfaqësues i Austrisë.

Në atë kohë, Z. Veber po orvatej të kthente në binarë të duhur reformën në Universitetin e Mitrovicës me sukses të konsiderueshëm në këtë fushë pasi që në atë kohë po e përvetësonim skemën e Bolonjës edhe në Universitetin e Mitrovicës. Në vitin 2003, Universiteti i Mitrovicës dukej më progresiv se Universiteti i Prishtinës, në të cilin kishte probleme të shumta me evropianizimin e tij dhe me praninë tashmë të shenjave të para të çështjes Arsimit Bajrami. Në atë kohë Universiteti i Mitrovicës ishte në rrugë të duhur, duke pasur edhe një rektor të aftë, Profesorin Gojko Saviq. Por, mjerisht pikërisht para suksesit vendimtar ishim dëshmitarë të një goditjeje fatkeqe ndaj këtyre proceseve. Kjo fatkeqësi ishte e motivuar nga frika e disa qarqeve të serbëve të Kosovës se reformat e qëndrueshme në Universitetin e Mitrovicës do të dobësonin fuqinë e atyre grupeve të cilat ishin kundër pajtimit, kundër mirëkuptimit dhe kundër integritetit të veriut të Kosovës në sistemin e institucioneve kosovare dhe në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) – tani e udhëhequr nga Agim Veliu, ndërkaq atëherë e udhëhequr nga Rexhep Osmani. Në atë kohë ishim dëshmitarë të një grushtshteti në Universitetin e Mitrovicës, i cili e solli Z. Papoviq në mënyrë të kundërligjshme në pozitën e rektorit. Kolegët dhe miqtë shqiptarë të Kosovës, të ulur tani rreth kësaj tryeze, do ta kujtojnë rolin e tij në të kaluarën në Universitetin e Prishtinës.

Me instalimin e kundërligjshëm të Z. Papovic ata e futën universitetin në grushtin e tyre, duke e bërë gradualisht në bazë të forcave radikale, në veçanti të dy personave – dhe nuk kemi asnjë arsye që të fshehim emra – të Marko Jakshiqit dhe Milan Ivanovicit, të cilët donin të bënin të njëjtën gjë që kishin bërë me spitalin e Mitrovicës, duke e shndërruar atë në vegël të vetën për agjitacion në Veri. Ishte ky një zhvillim që, në lojën për pushtet që po luhej në veri, i forconte pozitën e një grupi të serbëve në veri dhe i dobësonte dukshëm qarqet liberale dhe progresive të serbëve të Kosovës. Kjo çoi para së gjithash në situatë kur të rinjtë serb duhej të paguanin një çmim. Sepse, nëse një serb i Mitrovicës studion tani në Universitetin e Mitrovicës, do të kishit gjasa të merrnit një diplomë – këtu nuk do të diskutoj metodat e fitimit të kësaj diplome, nëse kjo do të ishte përpjekje intelektuale ose nëse do të involvonte dikë tjetër - pas të cilës do të mund të vazhdonit studimet në Serbi, Bjellorusi, ose në Rusi. Ndërkaq, nëse dëshironi të vazhdoni në njërin nga universitetet evropiane, kjo

diplomë dhe ky universitet më nuk janë të pranuar në Evropë. Kjo sjell deri te një proces shumë i vështirë i nostrifikimit: së pari do të duhet të shkoni në Beograd, atje diploma juaj do të njihet si diplomë universiteti e Begradit dhe, pastaj, me këtë diplomë të falsifikuar, ju do të mund të shkoni në Evropën perëndimore. E gjithë kjo situatë, në mënyrë shumë efektive, i ka vendosur serbët e Kosovës në margjinat e zhvillimeve akademike evropiane dhe më tutje rrezikon me përkeqësim të serioz të perspektivës së rinisë serbe të Kosovës.

Viti 2006 është vit fundamental, pos të tjerash edhe për shkak të rëndësisë së procesit të definimit të statusit. Ky është një proces shumë i fuqishëm, që ka sjellë në ndërkohë ndryshime rrënjësore në skenën politike. Po t'i kujtojmë vetëm ndryshimet në Kuvendin e Kosovës dhe në postin e kryeministrit dhe programin e ri shumë të hapur të kryeministrit të tashëm, Z. gjeneral Agim Çekut, i cili është personalitet shumë i fuqishëm, shumë i zoti dhe shumë i disiplinuar dhe një njeri i cili zakonisht realizon atë që dëshiron dhe bashkëpunimi me të cilin është i shkëlqyeshëm. Kryeministri ka nisur një program të besueshëm të bashkëpunimit me të gjitha komunitetet; më vjen keq që arsimit i lartë nuk është pjesë e procesit të standardeve, megjithëse së brendi ose në mënyrë implicite është bërë pjesë e procesit për definimin e statusit, pasi që njerëzit po e kuptojnë rëndësinë e adresimit të çështjes së arsimit të lartë. Në këtë kuptim kanë shprehur interesim në rritje të gjitha palët relevante, si për shembull PSSP-ja Z. Jessen Petersen, i cili është shumë i interesuar në këtë çështje, zëvendësi i PSSP-së, OSBE-ja që ka filluar të angazhohet tash, e të tjerë. Të gjitha këto tregojnë se përparimi në këtë fushë është më se i domosdoshëm.

Tashmë kemi pasur përparim të theksuar në këtë fushë; jam shumë i gëzuar për zhvillimet e fundit në Universitetin e Prishtinës, i cili jo vetëm e ka tejkaluar krizën Bajrami nga viti i kaluar, por tash e kanë tejkaluar edhe një krizë të dytë potenciale, e cila ka mundur ta dëmtonte universitetin më shumë se kriza Bajrami. Megjithatë, duke ju falënderuar punës së disa personaliteteve kyçe në Kosovë, ia arritëm të tejkalojmë edhe këtë krizë.

Në rastin e Universitetit të Mitrovicës nuk e kemi këtë moment të volitshëm të rrjedhave dhe na mungon çfarëdo përparimi në fushën e reformave. Në titullin e kësaj paraqitjeje kam përmendur disi pa vend ditën e pas statusit. Nuk mund ta them saktësisht se si do të duket ajo ditë kur të jetë definuar statusi, për shkak se ky është një vendim kompleks që merret nga shumë faktorë të rëndësishëm, por një gjë është e qartë: pas statusit veriu i Kosovës do të jetë në pozitë njësoj të vështirë sikur edhe sot dhe do të mbetet pjesë e Kosovës, për një arsye të thjeshtë sepse vullneti politik i komunitetit ndërkombëtar është kundër ndarjes së Kosovës. Rrjedhimisht, ju do të duhet të merreni me çështjen e Universitetit të Mitrovicës edhe pas definimit të statusit. Ju mund ta bëni këtë tani me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar, ju mund ta bëni këtë sivjet së bashku me PSSP-në dhe me UNMIK-un, ndërkaq vitin tjetër duhet të vazhdojë puna. Nga ana e qeverisë së Kosovës kërkohet qasjen e përgjegjshme për këtë çështje, gjë që, natyrisht, kërkohet edhe nga pala e serbëve të Kosovës. Unë vetëm mund të shpresoj që të dëgjohen zërat e serbëve të Kosovës, të cilët janë vërtetë të interesuar për të ardhmen e gjeneratës së tyre, të cilët do ta kuptojnë këtë dhe nuk do zhyten në lojëra politike duke e shfrytëzuar popullatën e vet.

Ne kemi nevojë për një qasje serioze të të dyja palëve, si të palës shqiptare, ashtu edhe të serbëve të Kosovës. Tani na duhet qëndrueshmëria. Duhet të mendojmë për një skemë të qëndrueshme të arsimit të lartë për serbët e Kosovës. Ka shumë mënyra për të menduar për qëndrueshmëri në këtë fushë dhe, nëse ju duhet një analizë e hollësishme, i keni ekspertët ulur në këtë sallë – edhe ju jeni ekspertë. Tani na duhet edhe pronësi; pronësi si e shqiptarëve ashtu edhe e serbëve të Kosovës. Na duhet riintegrim i fuqishëm i Universitetit të Mitrovicës në MASHT, në strukturat e IPVQ-ve, të cilat në një fazë do të humbin atë 'P' (të përkohshme) dhe atë 'I' (institucione), dhe do të bëhen struktura të plota të qeverisë – por jo më të përkohshme.

Na duhen të gjitha këto dhe na duhet të mendojmë për përfshirjen specifike të Serbisë në këtë çështje, pasi që është shumë e qartë se, pa marrë para sysh se cili do të jetë statusi i ardhshëm i Kosovës, gjithnjë do të ketë një lidhje speciale të serbëve të Kosovës me Serbinë. Pra, duhet të mendojmë për një skemë funksionale, veçanërisht në arsimin e lartë. Unë vetëm mund të ju apeloj të gjithëve, që punoni si ekspertë, të na ndihmoni të mendojmë për këtë çështje dhe të investoni potencialin tuaj intelektual në këtë çështje thelbësore dhe shumë të rëndësishme dhe ta aktualizoni me politikanë kudo që t'i takoni. Të gjithë pajtohemi se çelësi për të ardhmen e Kosovës është në masë të madhe arsim, arsim, dhe arsim.

Universiteti i Bozen/Bolzano – Histori e suksesshme tregjuhësore në Evropë

Prof. Oswin Maurer
Prorektor
Universiteti i Bozenit/Bolzanos, Itali

Do doja të nisim një rrugëtim, një rrugëtim ku të gjitha gjërat që i dini për strukturat universitare do të hidhen mënjanë; ku politikanët dhe akademikët kanë synuar dhe synojnë të arrijnë një qëllim të përbashkët i cili, në të njëjtën kohë, është edhe objektiv i pandarë – i quajtur arsim dhe krijim i potencialit për të ardhmen. Ky proces i krijimit të vlerave potenciale për të ardhmen në njëfarë mënyre mund të jetë e lidhur me kornizën ligjore, me gjuhët dhe me faktorë të tjerë të shumtë. Mirëpo, këto janë hollësitë, ndërkaq thelbi është shumë më i rëndësishëm: ne mëtojmë arritjen e praktikave më të mira dhe të rezultateve më optimale nga arsimi.

Kjo është pikërisht ajo që e përbën suksesin e rrëfimit të Universitetit të Lirë të Bolzanos. Krahasuar me këto që po diskutohen në Kosovë, edhe Bolzano kishte vështirësi me afatet shumë të shkurta, që manifestohen në faktin që aktet e para ligjore për financimin e universitetit ishin sjellë në vitin 1997, ndërkaq programet e universitetit kishin filluar në tetor të vitit 1998. Institucioni i jonë tashmë ka shtatë vjet e gjysmë jetë. Gjatë kësaj dekade, Universiteti i Lirë i Bolzanos është fillimi më i suksesshëm universitar tregjuhësor në Evropë. Ne kemi qenë dëshmitar të një rritjeje substanciale sa i përket programeve dhe numrit të studentëve: përderisa në planin e parë strategjik të universitetit theksohej arritja e numrit prej 2000 studentëve deri në vitin 2005, ne tani kemi arritur të regjistrujmë 3000 studentë në katër fakultete dhe shkolla të ndryshme. Në këtë moment, ne po ndërtojmë 'shkollën ose fakultetin e pestë', i cili do të fillojë veprimtarinë në vitin 2007, duke ofruar programe në fushën e shkencave natyrore e matematikore. Në bazë të planit të ri strategjik, në vitin 2008 do të arrijmë numrin prej 5000 studentësh të regjistruar në Universitetin e Lirë të Bolzanos; megjithatë, ky numër do të jetë edhe kufiri i epërm absolut për institucionin tonë. Ne nuk do të synojmë tërheqjen e më shumë studentëve, kryesisht me qëllim që të ruajmë nivelin e shkëlqyeshëm të cilësisë arsimore.

Ka pasur shumë komente lidhur me atë që do të duhej bërë në Kosovë – cila do të ishte strategjia e duhur për shoqërinë dhe universitetin tuaj. Më duhet të jem shumë i suksesshëm lidhur me dhënien e çfarëdo këshille, apo në ofrimin e 'modelit funksional'. Unë mund të paraqes vetëm një farë modeli, duke shpresuar që pjesë të tij të jenë të zbatueshme në situatën tuaj këtu. Z. Bayerl, në fjalimin e vet kryesor, e vuri në pah synimin e përbashkët të të gjitha përpjekjeve në Kosovë: ky ka të bëjë me arsimin, me kulturën, po edhe me shoqërinë. Pajtohem me këtë, por më duhet të shtoj edhe një gjë: ky synim ka të bëjë edhe me aspektin ekonomik!

Dhe ky ishte një nga dallimet e mëdha në perceptim që arritëm ta fusim në përdorim: politika e lartë dhe njerëzit e angazhuar në themelimin e këtij universiteti kuptuan se kjo ishte një çështje ekonomike e krijimit dhe kultivimit të vlerave.

Rreth 450.000 njerëz jetojnë në Tirolin Jugor me standard mbi mesataren e nivelit evropian.

Kjo pasuri historikisht ngritët mbi pozitën gjeografike të kësaj province, por edhe në ekonominë jashtëzakonisht të suksesshme të ditëve të sotme. Por, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se derisa po analizojmë situatën me qasje krahasuese ndërmjet Tirolit Jugor dhe Kosovës, ne nuk i jemi qasur çështjeve kyçe që u përmendën në prezantimet e mëparme; e kemi fjalën këtu për kornizën politike, ndjeshmëritë vendore, drejtësinë politike, faktin nëse ideja do të fitojë mbështetje ose jo, e të tjera. Megjithatë, ne do duhej të kufizohemi vetëm në njërin prej tyre dhe, sipas mendimit tim, në çështjen kyçe: a duam ne arsim? Po a Jo? Të gjitha argumentet dhe brengat e tjera mund të jenë me rëndësi, por vetëm mbase në nivelin e dytë të vendimmarrjes. Për këtë arsye duhet ta kthejmë diskutimin në pyetjen thelbësore: Çka duam dhe çka po synojmë? A duam ta shohim arsimin si opsion të ardhshëm të të rinjve në këtë vend pas 10, 15, apo 50 vjetësh?

As provinca e Bolzanos nuk është në pozitë aq të lehtë politike. Ajo është një provincë autonome në Itali dhe vendimmarrja dhe, në veçanti marrja e vendimeve politike, nuk është asnjëherë aq e lehtë siç mund të duket prej së jashtmi. Ishin arsye të ndryshme në favor të themelimit të Universitetit të Lirë të Bolzanos; në ndërkohë që diskutimet kishin filluar që nga fundi i viteve të pesëdhjeta, kur ishte diskutuar mundësia e themelimit të një institucioni të nivelit të tretë të arsimit. Momenti vendimtar ishte reforma ligjore e sektorit të arsimit në Itali, e cila kërkonte që mësimdhënësit e shkollave fillore dhe ata të nivelit parashkollor (të çerdheve) të kishin një diplomë të arsimit të lartë ose nga universiteti. Kjo e krijoi nevojën për themelimin e një institucioni që do të ofronte shërbime për përgatitjen e programeve dygjuhësore për përgatitjen e mësimdhënësve – një universitet dygjuhësor. Megjithatë, qeveria e Tirolit Jugor u angazhua në një qasje aktive dhe filloi të zhvillojë një plan strategjik të arsimit i cili e merrte parasysh situatën specifike linguistike dhe kulturore të Tirolit Jugor. Rezultati i parë ishte themelimi i një akademie kërkimore, e quajtur Akademia Evropiane (EURAC) në vitin 1992. Prej atëherë, EURAC është bërë e famshme për kërkimet e veta shkencore për dygjuhësinë dhe për formulimin e politikave në ambiente multietnike. Një tjetër hap ishte zhvillimi i një plani strategjik, të nxitur nga programi "Tirolit i Jugut 2000", i cili orvatet të përcaktonte situatën arsimore për një periudhë të ardhshme tetëvjeçare. U bënë studime të fizibilitetit të cilat, pos tjerash, tentonin të gjenin përgjigje edhe në një pyetje që u përmend sot këtu. Çka duam ne? Mirëpo, këto studime siguronin edhe orientim strategjik dhe përcaktonin përgjegjësitë për kohën kur do të fitonim atë që dëshironim? Cilat do të ishin përgjegjëshmëritë tona? Kjo pyetje dhe përgjigja në të janë shumë të rëndësishme. Jo vetëm të vendosim se çka duam, por edhe të përcaktojmë përgjegjësitë tona dhe zhvillimet e mundshme për të cilat do të duhet të japim llogari në të ardhmen.

Në vitin 1995 u bë prezantimi i strukturës së universitetit në Itali. Në atë kohë, sistemi universitar ka qenë ende shumë i centralizuar dhe projekt propozimet, përfshirë ato për themelimin e një universiteti të ri, duhej të shpallehin një vit para skadimit të planit të strukturës universitare në shkallë kombëtare. Kjo nënkuptonte që vala e ardhshme e propozimeve për periudhën 1997 – 1999 duhej të dorëzohej para fundit të vitit 1996, që në rastin tonë na obligonte që të shpallnim projektin e universitetit vetëm me një strukturë virtuale në dispozicion. Prej vitit 1995 deri në vitin 1997 kishim një situatë tipike: ndal – vazhdo – nuk kam ide; zhvilloheshin diskutime në të gjitha nivelet, gjithkush kishte 'mendimin' e vet për projektin dhe të gjithë shkëmbejnë ide për dhe kundër tij. Problemi kyç në situatë të këtilla është se shumica e njerëzve nuk kishin 'pikëpamje të informuar' kur diskutonin dhe shprehnin mendimet e veta lidhur me projektin e propozuar. Kishte shumë diskutime politike lidhur me mendimet për dhe kundër, përfshirë edhe një polemikë se do të themelohej një universitet italian në Bolzano dhe se kjo nuk ishte as e dëshirueshme e as e realizueshme. Të tjerë thoshin se universiteti i ri në Bolzano do të ishte jo më shumë se një universitet rajonal, pasi që një universitet i tillë tashmë ekzistonte në Innsbruck (Austri, i quajtur në Tirolin Jugor "universiteti i vendit"), vetëm 80 km në veri Bolzanos, një tjetër që funksiononte 50 km në jug të Bolzanos (Universiteti i Trentos), dhe universiteti i tretë që vepronte vetëm 100 km në jug të Bolzanos (Universiteti i Veronës).

Njerëzit mendonin se as që kishte nevojë për një universitet të ri. Mirëpo, pikërisht për këtë arsye në fillim thashë se do të niseshim në një rrugëtim imagjinar: nga aspekti historik, nga aspekti i ekonomisë tradicionale, dhe nga aspekti tradicional i logjikimit, nuk kishte nevojë që të themelohej një universitet të ri në afërsi të tre universiteteve të tjera.

Mirëpo, ndodhi një mrekulli me miratimin e të ashtuquajturit Ligji i Basaninit të vitit 1997. Ai paraqiste bazën ligjore për themelimin e Universitetit të Lirë të Bolzanos dhe i mundësonte qeverisë vendore të siguronte fondet për këtë universitet privat. "Privat" nuk do të thotë se ne jemi universitet privat sipas kuptimit në kontekstin ndërkombëtar. Kjo do të thotë se financimi nuk vjen nga Roma, por ne ende i nënshtrohemi kornizës ligjore italiane të universiteteve. Të gjitha rregullat përkritazi me programet arsimore dhe me administratën universitare janë të vendosura, megjithëse në kuadër të këtyre rregullave na lejohet pak fleksibilitet. Qeveria italiane siguron një pjesë të financimit, i cili tash arrin 5 % të buxhetit të përgjithshëm prej 35 milionë euro. Kryesisht kjo ka të bëjë me alokimet për numrin e përgjithshëm të të regjistruarve. Kontributi i ministrisë në buxhetin tonë është vërtetë i vogël, mirëpo kjo nuk është edhe aq e rëndësishme. Ne jemi në mesin e atyre pak universiteteve në Evropë ku buxheti i alokuar nuk shfrytëzohet në tërësi. Megjithatë, termi "i lirë" i referohet kryesisht privilegjit për të angazhuar personelin akademik edhe prej vendeve të tjera jashtë Italisë me kontakt të drejtpërdrejtë, gjë që, sipas legjislacionit në fuqi në Itali, nuk është e mundshme për universitetet e tjera. Ne jemi i vetmi universitet në Itali të cilit i është lejuar ta tejkalojë pesëpërqindëshin e emërimeve duke angazhuar 70 % të numrit të përgjithshëm akademik drejtpërsëdrejti prej vendeve të tjera.

Në thelb, suksesi i Universitetit të Lirë të Bolzanos ngritët mbi vizionin e qartë – të jemi një universitet ndërkombëtar në Itali me interes të veçantë vendor – që për fat të mirë ka pasur sukses në zbatim përkundër një farë kundërshtie vendore ndaj institucionit tonë. Së dyti, politikanët kompetentë dhe, në veçanti, kryeministri i Tirolit Jugor i kanë mbështetur fuqimisht dhe i kanë çuar përpara idenë dhe vizionin përkundër brengave të shprehura nga qeveria qendrore, nga komuniteti akademik në shkallë vendi, si edhe nga ana e komunitetit akademik në Austri. Shumë nga këta shikonin me dyshime në institucionin e vogël që po lindte: Bolzano, kush janë këta?

Disa ende na e bëjnë këtë pyetje, megjithëse kjo tash po ndodh gjithnjë e më rrallë. Ne e kemi bërë dhe vazhdojmë ta bëjmë punën tonë, duke filluar në një ambient mjaftë armiqësor, dhe përkundër të gjitha parashikimeve, tash disa vite ne jemi në gjendje të krijojmë vlera kulminante dhe shihemi si ofruar kulminantë të shërbimeve arsimore. Moment vendimtar për suksesin tonë ishte dhe vazhdon të jetë aftësia për të shfrytëzuar dritaret e hapura të mundësive. Pas miratimit të Ligjit Basanini njerëzit përgjegjës kanë mundur të merrshin me këtë apo atë aspekt të çështjes, por ata u përqendruan në gjetjen e përgjigjes në pyetjen: Çka duam nga e ardhmja? Arsimi është i pandashëm dhe, si i tillë, mund të krijojë vlera për provincën tonë, pa marrë parasysh diskutimet nëse në të do të zhvillohet mësimi në gjuhën gjermane apo në gjuhën italiane. Përkundër këtyre, siç u tha tashmë disa herë, ky universitet tash është një vend shumë i suksesshëm i arsimit. Është i suksesshëm sepse tërheq personelin akademik prej mbarë botës, edhe nëse një numër i konsiderueshëm prej tyre janë të kombësisë italiane. Ne po e ndihmojmë të ashtuquajturin proces të 'kthimit të trurit', duke i tërhequr akademikët e mirënjohur botërorë, por, gjithashtu duke krijuar mundësi për akademikët kulminantë italianë që veprojnë jashtë vendit që të kthehen në vendlindjen e vet. Ndërkaq sa i përket popullatës vendore, dhe kjo më herët u përmend nga Z. Bajerl, të rinj të mençur e të motivuar lartë të moshës prej 18 deri 25 vjeç ishin të detyruar të shkonin në provinca ose madje edhe në vende të tjera për të studiuar, dhe shumë prej tyre nuk ktheheshin më në Bolzano pas diplomimit. Kjo solli deri te mungesa e shkathtësive, e ekspertizës dhe e kompetencave në një sërë fushash profesionale, gjë që krijonte vështirësi kur duhej plotësuar pozitat udhëheqëse në kompani ose në administratën publike.

Çka tjetër e bën modelin e Universitetit të Lirë të Bolzanos të suksesshëm?

Së pari, arsimimi tregjuhësor u ofron të diplomuarve një varg shkathtësish gjuhësore të nevojshme në kontekstin e Evropës së bashkuar, si dhe në biznesin global. Mirëpo, përparësia e trigjuhësisë i ka edhe të metat e veta, kryesisht në funksionimin e institucionit tonë: ligjërisht, secili dokument duhet përkthyer në italisht dhe gjermanisht, shpesh i përkthyer fjalë për fjalë. Vetëm paramendoni sa herë do të pengoheni nga kuptimet e ndryshme të një shprehjeje italiane që duhet të përkthehet në gjuhën gjermane. Për këtë arsye dhe për të shmangur problemin e domethënies dhe kuptimeve të ndryshme, gjuha e komunikimit në institucionin tonë është gjuha angleze.

Së dyti, bashkësia jonë e mësimdhënësve e studentëve, të cilët vijnë nga 45 kombe dhe kultura të ndryshme, krijon një ambient unik të nxënies dhe të mësimdhënies. Së treti, proporcioni ynë i shkëlqyeshëm mësimdhënës – student prej 1 me 6 nuk haset në universitetet e tjera italiane, e madje as në ato evropiane, sidomos në ciklin e studimeve për Baçellor. Vetëm shkollat më elite ndërkombe të biznesit janë në gjendje të punojnë me një proporcion të këtyllë mësimdhënës – student, e këtë e bëjnë vetëm pasi që kërkojnë çmime elite për shërbimet e veta.

Së katërti, politikanët tanë prej Kryeministrit të Tirolit Jugor e deri te Ministri i Arsimit dhe Ministri i Financave e kuptojnë se për një universitet që ofron arsim të nivelit kulminant kërkohet infrastrukturë kulminante në shkallë ndërkombëtare dhe, rrjedhimisht, edhe financim të mjaftueshëm. Nëse nuk i keni mjetet, ju lutem mos e filloni; nëse filloni, duhet të jeni të parët, mbase të vegjël në madhësi, por kulminantë nga aspekti i shërbimeve të ofruara arsimore, për nga personeli mësimdhënës dhe infrastruktura.

E pesta, dhe pikërisht kjo e bën efikas Universitetin e Lirë të Bolzanos, është se të gjitha palët e involvuara kanë një vizion të përbashkët dhe janë pjesë e një strategjie e cila bazohet në konsensus e jo në kompromis.

Gjashtë, struktura e jonë qeverisëse është e ravigëzuar shumë qartë në statutin tonë. Organi kryesor qeverisës është Këshilli i Universitetit, i përbërë nga nëntë anëtarë, të cilët nuk duhet të mbajnë poste politike e as të ushtrojnë detyra politike; kjo vlen edhe për përfaqësuesit studentorë dhe profesorët në senatin tonë. Kjo është gjë shumë e mirë – ju lutem mos e bëni gabimin e instrumentalizimit të universitetit tuaj për asnjë agjendë politike. Organi kryesor akademik është senati, i cili përbëhet nga Rektori, prorektori, dekanët dhe prodekanët e katër shkollave si dhe nga anëtarët e senatit të cilët përfaqësojnë profesorët asistentë dhe studentët. Në nivel të shkollave/fakulteteve vendimet merren nga anëtarët e Këshillit të Shkollës/Fakultetit.

Megjithatë, të gjitha këto struktura funksionojnë vetëm sepse të gjitha këto institucione i përmbahen vizionit themelor dhe parimeve të përbashkëta strategjike: çka na duhet, çka duam të arrijmë, a na ndihmon kjo që të arrijmë qëllimet tona në mënyrë më efikase? Ne e arrijmë këtë duke u përqendruar në një apo dy qëllime përnjëherë dhe duke qenë shumë të saktë në definimin e tyre. Kjo nuk do të bëjë punë nëse gjithkush do të dal me 10 ose 15 'ide të mira' – përvoja nga universitetet tregon se këto janë zakonisht rezultat i sesioneve planizuese – pa sugjeruar se si do të implementohen ato, kush do të marr përgjegjësinë dhe kush do të jap llogari për to. Ne kërkojmë afate të sakta për arritjen e objektivave, caktimin e piketave, dhe një kornizë të qartë të vendimmarrjes dhe me rezultate të prekshme. Siç e përmenda në fillim të prezantimit tim, arsimimi është tepër i vlefshëm që t'u lihet vetëm politikanëve ose vetëm akademikëve; ai është një çështje e gjithmbarshme dhe më e rëndësishme shoqërore; por ky është edhe një çështje ekonomike: A krijojnë vlera veprimet tona arsimore? A e përmirësojnë nivelin arsimor të vijuesve të universitetit tonë? A i pajisin veprimet tona arsimore me "vlerë shtesë" krahasuar me universitetet e tjera?

Pos studentëve dhe të diplomuarve më se të kënaqur, rangimet e ndryshme konkurruese në shkallë vendi tregojnë qartë vlerat që kemi krijuar gjatë viteve të fundit. Për shembull, Shkolla e Ekonomisë dhe Menaxhmentit së voni u rangua numër 1 në Itali për herë të tretë me radhë nga ana e Asociacionit të Rektorëve të Universiteteve në Itali – që është një rezultat i jashtëzakonshëm dhe i papërsëritur për një institucion të ri. Pos kësaj, rangimet përkitazi me proporcionin personel – student dhe për infrastrukturën moderne në kontekst evropian janë në 10 përqindëshin e epërm në Itali.

Pra, cili është thelbi i suksesit? Nëse keni një vizion mund të shkoni larg. Këtë po e them si njeri që e ka përjetuar këtë disa herë në disa vende të ndryshme. Vizioni i qartë ju mundëson të përqendroheni në gjërat që mund të bëni.

Angazhoni njerëzit e përkushtuar, por ruajuni nga "qëllimmirët" të cilët japin një mendim, por zakonisht japin shumë pak rezultate të prekshme.

Kryeni detyrat e shtëpisë dhe mendoni përtej asaj që është e qartë. Mos tentoni t'i kopjoni modelet ekzistuese: secili universitet ka nevojë dhe e meriton vizionin, strukturën dhe strategjinë e vet.

Përqendrohuni në cilësi dhe përmbajtje; arsimi nuk ka të bëjë vetëm me strukturat, por edhe me atë se sa mësojnë njerëzit, sa i çmojnë dhe i vlerësojnë përvojat e nxënies në institucionin tuaj.

Mos e zgjeroni vizionin tuaj, mos u shmangni nga strategjia juaj, mos i komplikoni gjërat së tepërmi, përdorni mendjen e shëndoshë. S'do mend se do të bëni gabime, por gabimet janë pjesë e nxënies dhe, së këndejmi, edhe pjesë e punës sonë.

Sfidat dhe zgjidhjet për arsimin e lartë minoritar në Rumani

Prof. Mircea Bocsan

Universiteti Babes-Bolyai, Rumani

Së pari, do të doja të falënderoj Z. Pupovci për mirësinë e tij që më ftoi në këtë konferencë. Në të vërtetë, ashtu siç u pa gjatë këtij diskutimi, përpjekjet e tij dhe të kolegëve të tij, tashmë po japin efektet e veta.

Në letrën tuaj të cilën e pranua në Kluzh-Napoca, ne pamë se ju dëshironit të ndajmë me ju përvojat tona në fushën e arsimit të lartë për minoritetet. Universiteti ynë ka ca përvojë në këtë drejtim dhe unë do doja ta ndajë paraqitjen time në dy pjesë. Së pari, nuk është e mundur të ofrohet një model i dobishëm nëse nuk keni ca njohuri themelore për historinë e evolucionit të kësaj çështjeje në pjesën e Rumanisë prej nga vij unë. Së dyti, do doja t'ju informoj pak lidhur me gjendjen e tanishme në universitetin tonë dhe mënyrën se si e zbatuam strukturën shumëkulturore në të.

Cluj-Napoca është qyteti më i madh i Transilvanisë. Çka është Transilvania? Në të vërtetë ajo është një vend strategjik i Evropës; ajo ka qenë dhe mbetet një vend atraktiv për evroperëndimorët dhe, përgjatë shekujve, një arenë për luftëra politike dhe fetare.

Universiteti i Kluzhit ngritet mbi themelet e disa përpjekjeve për të nisur studime të arsimit të lartë për të filluar në vitin 1581. Po ashtu duhet të dini se Transilvania e banuar nga Rumunët ishte pushtuar nga Hungarezët prej shekullit të 11 deri në atë të 13. Në kolonizimet e mëvonshme të hungarezëve dhe të gjermanëve nga ana e pushtetit të atëhershëm hungarez gjenden rrënjët e të sotmes shumëkulturore të rajonit tonë. Themeli i parë i këtij universiteti ishte një kolegji i themeluar në vitin 1581 nga Princi Hungarez i Transilvanisë, Ishtvan Bthori. Ky kolegji u vendos nën kontrollin e jezuitëve dhe udhëhiqej nga një rektor italian - Antonio Possevino. Kolegji nuk pati jetë të gjatë pasi që princi i ardhshëm ishte një protestant; ai provoi të themelonte kolegjin e vet dhe, si rezultat, kemi një zbrazëti prej rreth 60 vitesh. Jezuitët u kthyen në vitin 1688 me një akademi të vogël dhe u orvatën të forcojnë ndikimin katolik në Transilvani. Po dua t'ju them se fillimi i universiteteve tona ishte një arenë e garave dhe përleshjeve fetare në mes të protestantëve dhe katolikëve. Kjo nuk ishte një kontest linguistik as kulturor, por një konflikt fetar. Çka ndodhi më tutje? Mbase mund ta dini se në vitin 1699 Transilvania u pushtua nga austriakët dhe Maria Tereza, perandreshë e atëhershme e Austrisë, në vitin 1776 mori një iniciativë për pajtim ndër fetar. Ajo themeloi një universitet në të cilin gjuhë e vetme mësimore ishte gjuha gjermane. Por kjo ndërmarrje nuk do të zgjaste shumë, pasi që djali i saj Jozefi i II, e zëvendësoi universitetin me një shkollë të mesme (e cila më vonë u bë e famshme) në të cilën gjuhë mësimore ishte prapë gjuha latine. Në kontekstin e ndryshimeve të vitit 1848, pas revolucionit evropian, u ngrit me ngulm çështja e themelimit të një universiteti në gjuhën vendore. Këtë herë, rumunët – të cilët gjithnjë kanë qenë shumicë në Transilvani – kërkuan një universitet për nevojat e veta. Kërkesa e tyre dukej se do të ishte e suksesshme në fillim, pasi që ministri hungarez i Arsimit Eotvos propozoi në vitin 1868 themelimin e Universitetit të Kluzhit, në të cilin do të studiohej në gjuhët hungareze, rumune dhe gjermane. Projekti i tij u hodh poshtë, ndërkaq në vitin 1872 autoritetet themeluan një universitet të ri – të cilat janë edhe themelet e

universitet modern të universitetit tonë. Institucioni i ri ishte paraparë që të zhvillonte mësimet vetëm në gjuhën hungareze. Në të vërtetë qëllimi i tij kryesor ishte ndërtimi i një kombi të vetëm hungarez dhe të promovonte gjuhën hungareze si gjuhë e vetme e tërë Transilvanisë. Ky vendim shkaktoi pakënaqësi të mëdha në mesin e popullatës hungareze. Për këtë arsye, pas ribashkimit të Transilvanisë (në vitin 1918) me territoret e tjera të banuara nga rumunët, qeveria rumune nga Bukureshti e mori nën kontroll universitetin – ashtu siç ndodhi edhe në Bratislavë e në Strasburg – dhe vendosi mësimdhënie vetëm në gjuhën rumune. Kjo zgjati deri në vitin 1949, kur ndodhi diçka shumë interesante: siç e dini, në atë kohë Rumania ishte e pushtuar nga Sovjetikët, të cilët e ndanë universitetin tonë në dy pjesë: në atë me mësim në gjuhë rumune i quajtur Babeş dhe në universitetin me mësim në gjuhën hungareze, të quajtur Bolyai. Për këtë arsye sot universiteti ynë sot quhet Babeş-Bolyai. Kjo vazhdoi kështu deri në vitin 1959, kur qeveria në Bukuresht mori vendim që të bashkojë këto dy universitete në një universitet më të fuqishëm. Përfundimisht, gjatë viteve të shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta, për shkak të politikave të gabueshme arsimore, u zvogëlu numri i profileve dhe drejtimeve dhe pati tkurrje të theksuar të numrit të studentëve. Si rrjedhojë, mësimdhënia në gjuhën gjermane humbi fare, ndërkaq ajo në gjuhën hungareze u zvogëlu dukshëm. Kjo ishte ajo pjesa historike që doja ta bëjë dhe tash po vazhdoj me një prezantim të situatës së tanishme.

Ne tani jemi një universitet shumëgjuhësor dhe shumëkulturor. Ku gjenden rrënjët e këtij orientimi? Natyrisht, në kontekstin historik të cilin posa e përshkrova; por ju duhet ta dini një gjë shumë të rëndësishme. Në dhjetor të vitit 1989, pas revolucionit, një grup i rëndësishëm dhe aktiv i akademikëve të rinj morën iniciativë për rindërtimin e traditës së profesionalizmit dhe demokracisë në universitetin tonë, gjithnjë me qëllim për integrimin e tij në botën e vlerave të botës së lirë. Ky grup lëshoi një proklamata në të cilën bazohet edhe karta e universitetit tonë.

Karta e Universitetit "Babeş-Bolyai" u aprovua në vitin 1995. Forma e tanishme është një formë e saj e modifikuar sipas rekomandimeve të Asociacionit të Universiteteve Evropiane dhe të seminarit të Salzburgut, si dhe pas zbatimit të sugjerimeve të bëra nga Ekselencia e tij Maks Van Der Shtul në vitin 2001.

Cili është misioni i universitetit të sotëm në Cluj-Napoca? Më lejoni të lexoj nenin e dytë të kartës. Ai thekson se:

"Misioni i Universitetit Babeş-Bolyai është planifikuar në këtë orientim. Ai promovon arsim dhe kërkime shkencore në përputhje me kërkesat e shoqërisë së bazuar në dije, përmes aftësimit fillestar, arsimit të vazhdueshëm dhe integritet në rrethin e vlerave ndërkombëtare. Ai siguron një kornizë për kontakte shumëkulturorë, shumëgjuhësore dhe ndërkonfesionale. Ai ofron mundësi të barabartë për aftësim për rumunët, hungarezët dhe gjermanët dhe, përfundimisht, i kontribuon zhvillimit vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar nga aspekti social, ekonomik, dhe kulturor duke u kyçur në rrjedhat e shoqërisë në harmoni me nevojat e komunitetit".

Ky mision reflektohet në nenin e tretë. I cili e thekson parimin e organizimit dhe të veprimtarisë. Do doja ta lexoj vetëm pikën e njëmbëdhjetë:

"Përdorimi i hungarishtes dhe i gjermanishtes ose i një gjuhe tjetër në përdorim të gjerë në mësimdhënie, kërkime shkencore, në publikime shkencore, si dhe në komunikimin ndërkademi nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi. Senati vendos për specializimet në të cilat do të sigurohet aftësim në gjuhët e minoriteteve kombëtare apo në gjuhët në përdorim të gjerë".

Këto që lexova më lartë janë pikat më të rëndësishme për çështjen e cila na intereson

ne. Cila ishte zgjidhja jonë shumëkulturorë? Më duhet të nënvizoj diçka: ju keni sjellë këtu në Prishtinë përfaqësues nga Universiteti Bolzano dhe nga Universiteti i Tetovës; në Evropë janë edhe dy universitete të tjera të rëndësishme shumëkulturorë: Friburgu i Zvicër dhe Akademia Abbo në Finlandë. Porse ne duhet të marrim parasysh disa dallime. Për shembull, Zvicra është një shtet konfederal; me tri gjuhë zyrtare; Rumania është shtet nacional me gjuhën rumune si gjuhë e vetme zyrtare. Për këtë arsye nuk mund të bëhet një krahasim i drejtpërdrejtë në mes nesh dhe Universitetit të Friburgut., atij të Bolzano apo Akademisë Abbo në Finlandë. Korniza jonë kushtetuese është e ndryshme dhe ne zgjedhëm këtë zgjidhje: ne themeluam disa drejtime të studimeve. Çka është një drejtim studimor në Cluj-Napoca? Ç'domethënie ka ai? Mund të mësoni në fakultetin e njëjtë në gjuhën rumune, hungareze, ose gjermane. Pra, në të njëjtin fakultet kemi tri drejtime me autonomi të vet. Çka nënkupton të jesh autonom? Kjo nënkupton mundësinë të mbledhësh fonde, të zgjedhësh njerëz, të kërkosh sponsorë dhe të kesh pavarësi në sjelljen e vendimeve. Dhe, me dëshirë do të lexoj për ju edhe një herë dy nene nga karta, të cilat kanë domethënie të madhe për këtë çështje. Njëri nga këta i referohet drejtimin të studimeve në departament.

"Drejtimi i studimeve në departament përfshinë të gjithë pjesëtarët e personelit mësimdhënës të cilët japin mësim në drejtimin e caktuar të studimeve në departament. Drejtimi i studimeve në departament udhëhiqet nga këshilli i departamentit i cili përfshinë drejtorin e drejtimin, të departamentit dhe një zëvendës."

Ka edhe një dispozitë lidhur me drejtorin e drejtimin të studimeve. Ai ka këto autorizime: ai "drejton procesin arsimor përkitazi me drejtimin e studimeve dhe siguron funksionim të duhur të tij. Marrëdhëniet ndërmjet kompetencave të drejtorit të drejtimin të studimeve dhe përfaqësuesve të drejtimin të studimeve në këshillin akademik të këshillit të fakultetit mund të miratohen nga Senati pas paraqitjes së kërkesës. Drejtori i drejtimin të studimeve duhet të sigurojë që të gjitha fushat e parapara për drejtimin e studimeve të jetë e mbuluar me personel përkatës akademik".

Për të përmbledhur këto çështje, sot 15 nga 21 fakultetet të universitetit tonë kanë programe studimi në gjuhën rumune dhe hungareze, ndërkaq 9 prej tyre ofrojnë programe në rumanisht dhe gjermanisht. Universiteti ynë ka rreth 47,000 studentë: rreth 37,000 janë rumunë, 9,500 hungarezë dhe më pak se 400 Gjermanë. Ne kemi edhe studentë hebraikë dhe në dy (Fakulteti i Teologjisë së Reformuar dhe Fakulteti i Teologjisë Katolike Romake) prej 21 fakulteteve kurset jepen vetëm në gjuhën hungareze, pasi vetëm hungarezët i përkasin këtyre religjioneve).

Ky është organizimi ynë multikultural, ndërkaq përfaqësimi është i garantuar në të gjitha nivelet e të gjitha organeve drejtuese. Për shembull, secili fakultet i cili ka drejtim të studimeve në gjuhën rumune apo gjermane, duhet të emërojë një prodekan i cili e përfaqëson këtë drejtim të studimeve; po ashtu kemi një sekretariat të përgjithshëm që i përfaqëson interesat e drejtimeve hungareze apo gjermane, si dhe kemi një program të studimeve që u kushtohet studimeve hebraike.

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë (UEJL) – prej sfidës politike në sukses akademik

Dennis J Farrington, DPhil,
Profesor dhe dekan i Fakultetit Juridik, Universiteti EJJL

1. Hyrje

Kam qenë i angazhuar në vende të ndryshme të këtij rajoni tash pesëmbëdhjetë vjet. Dhe kam përvojë të konsiderueshme në Kosovë, pasi që kam pasur rol të rëndësishëm në hartimin e ligjit për Arsimin e Lartë në vitet 2000 – 2002. I emëruar nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane (AUE) kam qenë anëtar i grupit të ekspertëve për reformimin e strukturave qeverisëse të Universitetit të Prishtinës. Së këndejmi, mendoj se di diçka për këtë çështje dhe, kuptohet, kam edhe mendimet e mia personale. Mirëpo, qëllimi i këtij prezantimi është të ju informoj lidhur me UEJL-në. Shumë nga pjesëmarrësit në këtë Forum dhe lexuesit eventual të këtij shkrimi, sidomos ata që i përkasin komunitetit shqiptar në Kosovë, janë të njohur mirë me UEJL-në. Tashmë ekziston një libër "UEJL – Katër vitet e para" në dispozicion për secilin pjesëmarrës dhe organizatë që dëshiron ta ketë.

Universiteti i Evropës Juglindore i Tetovës (UEJL) është përshkruar nga shumë vëzhgues si një 'model' i arsimit të lartë shumetnik dhe shumëgjuhësor. Ai është themeluar në rrethanat e veçanta të vitit 2001 në Republikën e Maqedonisë dhe, megjithëse mund të mos jetë e mundur të kopjohet në vende të tjera me situatë të ngjashme etnike dhe gjuhësore, zhvillimi i tij ofron orientim të dobishëm për palët e interesuara. Asgjë nuk do të ishte arritur pa udhëheqjen frymëzuese të ish - Komisionerit të Lartë për Pakicat Kombëtare (KLPK) të OSBE-së, Ekselencës së tij Maks Van Der Shtul, përpjekjet e të cilit për promovimin e arsimit të lartë dygjuhësor në Rumanë dhe gjetkë janë pranuar gjithandej. Pos kësaj, projekti kishte edhe përkrahjen e qeverisë së atëhershme maqedonase dhe, me ndihmën e donacioneve të huaja, ia arriti të ndërtojë një universitet të ri brenda një periudhe prej më pak se 12 muajsh, dhe vendosi një strukturë menaxhuese e cila, brenda disa vitesh të para, u shndërrua në një strukturë moderne qeverisëse të pranuar nga AUE pasi që plotësonte standardet moderne evropiane. Tri elementet: udhëheqje e mirë, mbështetja vendore dhe financimi adekuat, ishin arsyt kryesore për suksesin e UEJL-së. Sipas mendimit tim, asnjë formë e "zgjidhjes së imponuar" nuk do të kishte funksionuar në këtë rast.

2. Situata në Republikën e Maqedonisë

Republika e Maqedonisë (e njohur nga BE-ja dhe KB-ja me emrin kalimtar IRJM, më tutje në këtë tekst do t'i referohemi si Maqedonia), sipas regjistrimit të vitit 2002, ka një popullatë prej pak më shumë se dy milionë banorë, prej të cilëve 65 % janë deklaruar maqedonas, 25 % shqiptarë, rreth 4 % turq, 3 % romë dhe 3 % të tjerë. Përdorimi i "gjuhës amtare" tregon një gjedhë të njëjtë të përgjithshme. Duke respektuar trajtimin e çështjes së përdorimit të gjuhëve në dokumente të ndryshme ndërkombëtare "askush nuk do të diskriminohet nga ana e autoriteteve publike në bazë të gjuhës", çështja kryesore ishte si të sigurohen kushte të barabarta në qasjen në arsim për qytetarët që i përkasin dy gjuhëve krejtësisht të kundërta: gjuhës shtetërore maqedone (një nga gjuhët e sllavëve të jugut që shkruhet me alfabet cirilik) dhe gjuhës shqipe (një gjuhë unike indo-evropiane e shkruar në alfabet latin). Siç tregojnë edhe shifrat, popullata shqiptare nuk është saktësisht një pakicë; ajo përbën një pjesë substanciale të popullatës. Në praktikë, shumica e qytetarëve shqiptarë të zonave rurale dhe ata të zonave urbane e flasin gjuhën maqedone, pasi që e kishin mësuar si lëndë të detyrueshme në shkollë, ndërkaq vetëm një numër i vogël i maqedonasve e flasin gjuhën shqipe. Rajonet perëndimore të Maqedonisë, të dominuara nga shqiptarët, kanë lidhje të ngushta historike dhe familjare me Kosovën e dominuar nga shqiptarët, e cila prej vitit 1991 e deri në përfundim të konfliktit në vitin 1999 ishte e dominuar nga gjuha serbe. Folësit e maqedonishtes, në anën tjetër, kanë lidhje të ngushta me Serbinë dhe Malin e Zi ose me Bullgarinë: gjuha maqedone ka shumë ngjashmëri me gjuhët e tjera të sllavëve të jugut – me gjuhën serbe (dhe boshnjakishten e kroatishten) dhe në veçanti me gjuhën bullgare, por asnjë afërsi me gjuhën shqipe.

Para vitit 2000, arsimi i lartë në Maqedoni është organizuar ekskluzivisht në gjuhën maqedone, me përjashtim të një dege të vogël për aftësimin e mësimdhënësve të universitetit kryesor shtetëror Kiril e Metodi në Shkup, e cila ofronte disa kurse në gjuhën shqipe dhe, kuptohet, gjuhën shqipe si kurs të veçantë. Kuptohet se kjo merrej si mohim i të drejtës për qasje të barabartë në arsimin e lartë nga ana e komunitetit shqiptar. Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) ishte një përgjigje e negociuar politikisht e bashkësisë ndërkombëtare ndaj kërkesave për arsim të lartë në gjuhën shqipe. Ai u themelua për të ndihmuar në zgjidhjen e problemit të përfaqësimit të ulët të studentëve në gjuhën shqipe në institucionet e pranuar të arsimit të lartë në Maqedoni, por, në të njëjtën kohë, duke qenë i hapur edhe ndaj studentëve nga të gjitha grupet e tjera etnike. Në kohën kur filloi punën UEJL në vitin 2001 / 2002 me rreth 900 studentë, 95 % prej tyre ishin shqiptarë dhe përbënin vetëm 5 % të brezit përkatës të përfshirë në shërbime të arsimit të lartë të pranuar nga shteti (krahasuar me 20 % të atyre që flisnin maqedonishten). Në vitin 2005 / 2006 numri i studentëve arriti në rreth 6000, me rreth 75 % prej tyre shqiptarë, dhe me përfshirje prej 14.5 % të të rinjve të brezit përkatës në arsim të lartë vetëm nga UEJL. Pas themelimit të Universitetit Shtetëror të Tetovës në vitin 2004, i cili e trashëgoi Universitetin e Tetovës (i themeluar në vitin 2004, por me diploma pothuajse të pavlefshme), qasja e shqiptarëve në arsimin e lartë tash në përgjithësi është e njëjtë me përfshirjen e maqedonasve, megjithëse ende nuk ka fakultete që ofrojnë programe të pastra shkencore, mjekësi, inxhinieri, dhe fusha të ngjashme në gjuhën shqipe.

3. Obligimet ndërkombëtare të Maqedonisë

Obligimet ndërkombëtare të Maqedonisë i lejuan OSBE-së dhe Këshillit të Evropës për të kërkuar një ndryshim në politikat shtetërore me qëllim që të lejohet themelimi i UEJL-së. Në vitin 1988 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës aprovoi Rekomandimin 1353(1988) për qasjen e minoriteteve në arsimin e lartë: siç dihet mirë kjo do të thotë se arsimi është e drejtë themelore dhe për këtë arsye duhet siguar qasje të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit, përfshirë edhe arsimin e lartë, për të gjithë banorët me vendqëndrim të përhershëm në të gjitha vendet anëtare të Konventës Kulturore Evropiane (KKE). Maqedonia e ka nënshkruar KKE-në në vitin 1995, duke e ratifikuar edhe Konventën e veçantë Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (KEDNJ) në vitin 1997. Rekomandimi i vitit 1988 thotë se shtetet anëtare me pakica duhet t'i shmangen ligjësimin të përdorimit ekskluziv të gjuhës zyrtare. Ai po ashtu e njeht të drejtën themelore për të ndjekur arsim të lartë dhe për të themeluar institucione për këtë qëllim. Këto institucione, sipas këtij Rekomandimi, do të mbështeten zyrtarisht pas konstatimit të nivelit të duhur të cilësisë – në mënyrë jodiskriminuese dhe të drejtë – si dhe pasi të jetë konstatuar kërkesa e mirëfilltë për ekzistimin e tyre; gjuha nuk duhet të jetë kriter për njohjen e institucioneve ose të kualifikimeve të fituara. Po ashtu, në përgjithësi, anëtarët e Hapësirave Evropiane të Arsimit të Lartë dhe të Shkencës me dëshirë janë të përkushtuar për të siguruar një shkallë të uniformitetit në sistemet e arsimit të lartë në Evropë, por në të njëjtën kohë duke e ruajtur diversitetin e qasjes. Këto të gjitha synojnë që, përmes ndryshimeve të legjislacionit apo në mënyra të tjera, të krijojnë një kornizë të kualifikimeve kompatible dhe të krahasueshme duke synuar t'i përshkruajnë ato nga aspekti i ngarkesës me punë, nivelit, rezultateve të nxënies, kompetencave dhe profileve. Uniformiteti i qasjes mëton të rris mundësitë për mobilitetin e studentëve; Bashkimi Evropian e konsideron të realizueshëm objektivin prej 20 % mobilitet deri në vitin 2010 duke pasur para sysh theksimin e rëndësisë së nxënies së gjuhës së përbashkët (zakonisht gjuha angleze) në kuadër të Kornizës së Përbashkët Evropiane (KBE), e cila do të diskutohet më vonë.

Gjuha shqipe përputhet me definimin e gjuhës minoritare ose të gjuhës rajonale në Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale ose Minoritare (KEGjRM) (1992), e cila hyri në fuqi në vitin 1998. KEGJRM ishte nënshkruar nga Maqedonia në vitin 1996 por nuk është ratifikuar ende sot në vitin 2006, kështu që në kohën e këtij shkrimi shtetin nuk e obligojnë konditat e Kartës për promovimin dhe mbrojtjen e përdorimit të shqipes në arsim. Megjithatë, në vitin 1998 Maqedonia e ratifikoi Konventën më të përgjithshme Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKMPK) (1995), e cila i obligon palët për promovimin e mundësive të barabarta për qasje në të gjitha nivelet e arsimit për njerëzit të cilët u përkasin pakicave kombëtare. Palët obligohen që, në kuadër të sistemeve të veta arsimore, të njohin se personave që u përkasin pakicave minoritare u takon e drejta për të themeluar dhe për të menaxhuar institucionet e veta private arsimore dhe entet aftësuese, gjë që nuk do të nënkuptojë kurrfarë obligimesh financiare nga shteti.

4. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Maqedonisë thekson se prindërit kanë të drejtë dhe obligim për të siguruar arsimimin e fëmijëve të tyre (Neni 4); se të gjithë qytetarët kanë të drejta të barabarta për arsimim; dhe se shkollimi themelor është i detyrueshëm dhe pa pagesë (Neni 44).

Institucionet private arsimore mund të themelohen në të gjitha nivelet por arsimimit themelor (Neni 45).

Zgjidhja e parë politike e problemit të arsimit të lartë të shqiptarëve ishte Ligji i Arsimit të Lartë i vitit 2000, në të cilin isha angazhuar edhe unë si ekspert i Këshillit të Evropës, dhe Z. Maks Van Der Shtul i involvuar aktivisht si KLPK; ky Ligj parashihte të drejtën e komuniteteve për arsim të lartë në gjuhën e tyre, por në institucione jo-shtetërore. Pra, ishte ky një kompromis, dhe më duhet të them se ishte ky një kompromis i arritur me vështirësi të shumta pasi që kishte kundërshtim të konsiderueshëm nga shumica maqedone. Më në fund, Ligji kaloi në Parlamentin e Maqedonisë me një margjinë të vogël. Prandaj ishte kjo një përlëshje e vështirë politike për të arritur deri aty dhe, UEJL-ja ishte themeluar si një institucion i tillë me mbështetje ndërkombëtare në vitin 2001. Mirëpo, arsimit të lartë në gjuhë të tjera jomaqedone mund të ofrohej vetëm në institucione të financuara në mënyrë jo-publike. Zgjidhja e dytë politike arriti pas konfliktit të vitit 2001 në Maqedoni, i cili solli deri te marrëveshja kornizë e Ohrit; nga e gjithë kjo rezultoi një ligj i ri i arsimit të lartë në vitin 2003, i cili e plotësonte atë të vitit 2000. Ky ligj parashihte të drejtën për arsim të lartë në një gjuhë të komuniteteve në institucione të financuara nga shteti. Kështu, për herë të parë, mund të organizohej mësimi në gjuhën shqipe në institucionet e financuara nga shteti, por me kusht që të mësohej edhe gjuha maqedone; kjo ishte orvatje e qeverisë për të stabilizuar situatën pas konfliktit duke u siguruar që sa herë që të përdorej gjuha shqipe, të mësoheshin së paku disa lëndë në gjuhën maqedone. Kjo solli deri te themelimi i Universitetit Shtetëror të Tetovës nga ana e Parlamentit të Maqedonisë. Ishte ky një institucion i ri i themeluar me mbylljen e Universitetit të Tetovës, i cili, siç e shpjegova më herët, nuk ishte njohur asnjëherë. Tani kemi dy universitete në Tetovë: Universitetin e Evropës Juglindore dhe Universitetin Shtetëror të Tetovës. Këta janë përafërsisht 400 metra larg njëri tjetrit, pothuajse në kuadër të të njëjtit kompleks arsimor, pasi që në po këtë hapësirë është ndërtuar edhe Shkolla e Mesme e Mjekësisë dhe tashmë ekziston një Shkollë më e vjetër e Mesme e Bujqësisë. Pra, të gjithë janë në të njëjtën hapësirë, por në institucione të ndara.

Ligjërisht, kushtetuta ishte plotësuar pas "Marrëveshjes Kornizë të Ohrit" të gushtit të vitit 2001. Neni 7(6) i kushtetutës parasheh që "në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku së paku 20 % e popullatës e flet një gjuhë të caktuar, ajo gjuhë dhe alfabeti i saj do të përdoren si gjuhë zyrtare pos gjuhës maqedone dhe alfabetit cirilik. Lidhur me gjuhët e folura nga më pak se 20 % e popullatës, autoritetet vendore do të vendosin për përdorimin e tyre në organet publike". Neni 48(4) i kushtetutës parasheh që "Anëtarët e komuniteteve kanë të drejtë për mësim në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm, siç përcaktohet me ligj. Në shkollat në të cilat mësimi mbahet në ndonjë gjuhë të huaj, do të mësohet edhe gjuha maqedone". Pos ndryshimeve të tjera të bëra në legjisllacion me qëllim të realizimit të kësaj dispozite, janë bërë edhe ndryshimet e plotësimet në ligjin për arsimin e lartë në vitin 2003, të cilat kanë lejuar institucionet e financuara nga buxheti publik që të ofrojnë kurse në gjuhën shqipe, si edhe në gjuhën maqedone. Neni i ndryshuar 95 i Ligjit për Arsimin e Lartë parasheh:

1. Gjuha maqedone është gjuhë mësimi në institucionet e arsimit të lartë. Në përputhje me këtë Ligj dhe me Statutin e institucionit të arsimit të lartë, dhe me qëllim të shprehjes, të kultivimit, dhe të zhvillimit të identitetit dhe të veçorive të tyre, anëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë të gëzojnë arsimim në institucionet Shtetërore të arsimit të lartë, përmes disa programeve studimore në gjuhën e komunitetit, e cila nuk do të jetë gjuha maqedone. Shteti do të sigurojë financim për arsimin e lartë në gjuhën e cila përdoret prej së paku 20 % të popullatës në Republikën e Maqedonisë.

2. Mësimdhënia në institucione private arsimore mund të zhvillohet në gjuhët e pjesëtarëve të komuniteteve të cilat nuk janë shumicë ose në ndonjë nga gjuhët botërore. Kur gjuha e mësimi është gjuha e pjesëtarëve të komuniteteve të cilat nuk janë shumicë ose në një gjuhë botërore, gjuha maqedone do të mësohet si lëndë e veçantë dhe gjuha maqedone do të përdoret si gjuhë e mësimi në së paku dy lëndë të tjera.
3. Arsimit themelor dhe arsimimi në lëndët metodike dhe didaktike për mësimdhënës të shkollave të mesme mund të mbahet në gjuhët e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Ligjëratat në institucionet e arsimit të lartë mund të mbahen në një nga gjuhët botërore për programet e caktuara studimore të gjuhëve të huaja, për pjesë të programeve studimore të cilat ligjërohen nga profesorë mysafirë prej vendeve të tjera dhe për programe studimore të cilat ligjërohen në gjuhën maqedone dhe në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni. Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë që ligjëratat për programin e plotë studimor të zhvillohen në mënyrë paralele në gjuhën maqedone dhe në një nga gjuhët botërore.
4. Në institucione private të arsimit të lartë, ligjëratat mund të zhvillohen në gjuhët e pjesëtarëve të komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë ose në gjuhë të huaja. Kur ligjëratat mbahen në gjuhët e pjesëtarëve të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë ose në gjuhë të huaj, gjuha maqedone do të studiohet si lëndë e veçantë dhe ligjëratat do të mbahen në së paku dy lëndë të tjera në gjuhën maqedone.
5. Kur ligjëratat mbahen në gjuhët e pjesëtarëve të komuniteteve të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, në përputhje me paragrafët 2, 3, dhe 4 të këtij Neni, gjuha maqedone do të mësohet si lëndë e veçantë dhe ligjëratat do të mbahen në gjuhën maqedone dhe së paku dy lëndë të tjera do të studiohen në gjuhën maqedone. Lëndët do të përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë, ku do të përcaktohet edhe fondi i ligjëratave, të përcaktuara në Rregullat e normave dhe standardeve për themelimin e institucionit të arsimit të lartë dhe për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë.
6. Në institucionet shtetërore të arsimit të lartë, si pjesë e përcaktimit të kushteve në konkursin për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, universitetet do të sigurojnë përfaqësim të barabartë të qytetarëve, të cilët u takojnë komuniteteve të cilat janë pakica në Republikën e Maqedonisë, përmes kuotave plotësuese, të përcaktuara nga Qeveria e Maqedonisë'.

5. Zhvillimi UEJL-së

Në vitin 2001-2002 kur filloi UEJL-ja, ne kishim rreth 950 studentë, prej të cilëve rreth 95% shqiptarë; asokohe nuk ishte shumë e lehtë të udhëtohej prej Shkupit në Tetovë, pasi që autostrada nuk ishte përfunduar ende dhe kishte shumë pika kontrollimi të policisë dhe bllokada të tjera në rrugë; ishte e vështirë për maqedonët dhe të tjerët të udhëtonin nga Shkupi dhe pjesët e tjera të rajonit për të arritur në këtë zonë. Themelimi i UEJL-së dhe mosnjohja e 'Universitetit të Tetovës' shihej nga pjesa më e madhe e komunitetit shqiptar si e mangët dhe, rrjedhimisht, UEJL-ja iu nënshtrua sulmeve të caktuara, kryesisht propaganduese dhe kritikuese, por kohë pas kohe edhe sulmeve fizike. Shumë punëtorë të UEJL-së dhe të tjerë bëheshin të ndiheshin të shqetësuar për përkrahjen që i bënin këtij projekti. UEJL varej nga mbështetja ndërkombëtare: gati 40 milionë euro ishin zotuar nga

bashkësia ndërkombëtare, me pjesëmarrjen më të madhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Mbretërisë së Holandës: këtyre dy vendeve u mbesim borxh dhe u jemi mirënjohës.

UEJL tani është institucion që mund të mbajë vetveten; ne tashmë nuk pranojmë ndonjë donacion të konsiderueshëm financiar. Mbështetja kryesore që marrim për momentin është përmes bursave të cilat orvaten të merren me problemin e qasjes në arsim të lartë për studentët nga grupet me të ardhura më të ulëta dhe, përsëri i mbetemi borxh Holandës, pasi që ata, së bashku me Institutin e Shoqërisë së Hapur, janë donatorët më të mëdhenj. I vetmi donacion tjetër i rëndësishëm ndërkombëtar momentalisht është një shumë prej 2.5 milion eurosh nga Komisioni Evropian, përmes Agjencisë Evropiane të Rindërtimit, të ndara për ndërtimin e më shumë ndërtesave. Kjo ndihmë erdhi si rezultat i një vlerësimi të fizibilitetit të kryer nga OECD-ja në vitin 2003. Vlerësimi i OECD-së kishte rekomanduar një shumë prej 4 milionë eurosh, që do të na mundësonte të bënim më shumë në fushën e arsimit afarist për të ndihmuar ekonominë në zhvillim, por Komisioni Evropian nuk i kishte në dispozicion këto mjete për këtë qëllim në Maqedoni.

Struktura e studentëve sipas vendeve është 89 % nga Maqedonia, 7 % nga Kosova, 2 % nga Serbia dhe Mali i Zi pa Kosovë, shumë nga Presheva, dhe të tjerët nga Shqipëria dhe nga vende të tjera, kryesisht të kthyer nga diaspora; kështu në UEJL kemi njerëz nga Belgjika, Suedia dhe gjetkë, të cilët janë fëmijë që e kishin lënë Maqedoninë, Kosovën e Shqipërinë gjatë viteve të vështira. Tash nga ky vit akademik kemi studime (dhe diploma përkatëse) nga cikli i parë tre-vjeçar me Procesin e Bolonjës të implementuar brenda një periudhe prej katër vitesh, kemi studime për master të filluara tetorin e kaluar, dhe këtë vit fillojmë me programet për doktoratë. Tani, po ashtu kemi një Buletin të Hulumtimeve (Research Review), i cili po botohet për herë të tretë; kjo tregon se tash jemi përqendruar më shumë në hulumtim – jo vetëm në mësimdhënie. Programet akademike janë Juridiku, Administrim Biznesi, Administratë Publike, Shkencat e Komunikimit dhe Teknologjitë, dhe Përgatitja e Mësimdhënësve. Me përjashtim të Përgatitjes së Mësimdhënësve dhe Administratës Publike programi akademik është një përshkrim tipik i një universiteti privat jashtë sektorit shtetëror. Por ne gjithmonë kemi theksuar se jemi të interesuar të përmirësojmë qasjen e popullatës shqiptare në Administratën Publike dhe të përmirësojmë arsimin e mesëm për shkollat dhe mësimdhënësit shqiptarë. Kështu, edhe Administrata Publike dhe Përgatitja e Mësimdhënësve, të cilat zakonisht nuk gjenden në universitete private, janë pjesë e programit tonë të studimeve.

Pranimi në ciklin e parë varet nga mjetet tona në dispozicion. Ne kemi 'x' grupe në gjuhën shqipe, dhe 'y' grupe në gjuhën maqedone varësisht nga resurset për të mbajtur mësimin në një lëndë. Në përgjithësi kjo na sjell deri te rreth 75% të studentëve shqiptarë dhe 25 % maqedonë, duke mos u bazuar në diskriminim politik, në kuota ose në gjëra të tjera të tilla, megjithëse ka disa kurse në të cilat ka më shumë studentë maqedonas, dhe disa në të cilat ka më shumë studentë shqiptarë. Të gjithë studentët i mësojnë gjuhët vendore, kështu që shqiptarët mësojnë gjuhën maqedone dhe, për herë të parë në Maqedoni, maqedonët zyrtarisht mësojnë gjuhën shqipe. Më herët ishin të paktë ata maqedonas që flisnin gjuhën shqipe; tani ata mund të flasin shqip, përzihen me të tjerët në kafene, flasin me njëri-tjetrin dhe të gjithë këta mësojnë edhe gjuhën angleze. Siç e përmendëm më lartë, Ligji për Arsimin e Lartë ende kërkon mësimin e gjuhës maqedone dhe zhvillimin e së paku dy lëndëve në gjuhën maqedone.

Ne po hasim në probleme në mësimdhënien e kurseve në gjuhën shqipe, para së gjithash për shkak të kapaciteteve të vogla kadrovike; për shembull, universiteti ynë ka angazhuar shumicën e bartësve të titullit doktor në fushën e drejtësisë në Kosovë dhe në Maqedoni. Kështu, shumë nga profesorët e Universitetit të Prishtinës, me titullin doktor, japin mësim në universitetin tonë. Kuptohet se këtu ata kanë marrëdhënie të çrregullt pune, por kemi

edhe mësimdhënës të rregullt. Ne kemi vetëm një numër të vogël të librave universitare në gjuhën shqipe ose maqedone të cilat janë të pranuar ndërkombëtarisht si referenca. Në të vërtetë, gjuha shqipe përdoret nga më shumë folës se sa gjuha maqedone, kështu që ka më shumë qasje në informata në gjuhën shqipe se sa në atë maqedone. Ka pak burime në internet në gjuhën shqipe dhe fare pak revista shkencore po në këtë gjuhë. Kemi probleme të shumta me gjuhën dhe terminologjinë; dëgjuam më herët për probleme të shumta me përkthimet nga Italishtja në gjermanishte dhe në anglishte nga kolegu ynë nga Bolzanoja, por edhe më e vështirë është gjendja me përkthimet nga gjuha shqipe në maqedonishte ose prej anglishtes në maqedonishte, ose edhe prej anglishtes në shqip. Disa thonë se gjuha shqipe është në një proces të prishjes: fjalët e gjuhës angleze futen në përdorim në gjuhën shqipe me disa modifikime të vogla për të cilat përkrahësit e përdorimit të pastër të gjuhës shqipe thonë se janë të gabueshme; për shembull, sipas këtyre ekspertëve, fjala 'menixhment' (management) nuk është fjalë në shqip po në 'albish' (përngjitje e fjalëve Albanian – English në gjuhën angleze v. e p.). Ndërkaq kërkesa për të mbajtur mësim edhe në gjuhën maqedone, që është detyrim ligjor, ose të punësohet personel maqedonas, i shton edhe më shpenzimet dhe, rrjedhimisht, edhe koston e studimeve, në një situatë kur i tërë projekti nuk përkrahet nga shteti. Mbështetja e vetme nga shteti ka qenë dhënia e tokës për ndërtim dhe disa bursa, dhe asnjë përkrahje tjetër përkundër dispozitave të Marrëveshjes së Ohrit.

6. Përdorimi fleksibil i gjuhëve

Korniza e Përbashkët Evropiane e Këshillit të Evropës për nxënien e gjuhëve ofron një bazë të përbashkët për elaborimin e planeve mësimore të gjuhëve, udhëzime për planprogramet, provimet, tekstet shkollore, e të tjera, në tërë Evropën. Ajo e përshkruan në mënyrë të përgjithësuar se çka duhet të mësojnë nxënësit e gjuhës me qëllim të përdorimit të gjuhës për komunikim dhe cilat dije dhe shkathtësi duhet të përvetësojnë për të vepruar në mënyrë efektive. Ky përshkrim e përcakton edhe kontekstin kulturor në të cilin është vendosur gjuha e caktuar. Ky dokument paraqet bazën e qasjes së re ndaj nxënies së gjuhëve në UEJL. Nëse i marrim para sysh objektivat e Kornizës, dhe në përputhje me Ligjin, UEJL kërkon nga studentët njohje solide të gjuhëve shqipe dhe maqedone. Kjo e ndihmon procesin e integritit të studentëve dhe e përforcon diversitetin gjuhësor dhe kulturor, një nga përparësitë më të mëdha dhe njëkohësisht karakteristikën identifikuese të UEJL-së. Puna e UEJL-së u mundëson studentëve nga të dyja grupet kryesore gjuhësore që të vijnë arsimin e lartë të një cilësie të krahasueshme me atë të institucioneve arsimore perëndimore.

Baza ligjore për politikën gjuhësore të UEJL-së është paragrafi 4 i Nenit të reviduar 95 të Ligjit për Arsimin e Lartë, i cili mbetet pothuajse i pandryshuar prej vitit 2000. Koncepti i 'qasjes fleksibile' ndaj gjuhës është miratuar në UEJL gjatë viteve 2002-2003, sikur edhe politikat mbi 'përdorimin fleksibil të gjuhëve' e cila përkon qysh me Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës R(98)6 përkritazi me gjuhët moderne. Ky Rekomandim inkurajon programet e mësimdhënies në të gjitha nivelet të cilat përdorin qasje fleksibile, gjithnjë duke pasur parasysh Konventat e ndryshme të diskutuara më herët. Rekomandimi promovon pikëvështrimin e mirëfilltë ndërkulturor të inkurajuar nga arsimimi dygjuhësor dhe dykulturor, dhe thekson nevojën për numër të mjaftueshëm të mësimdhënësve të kualifikuar të gjuhës. 'Politikat fleksibile gjuhësore' po ashtu përmenden edhe në Nenin 5.3 të Rekomandimit R (98)3 të Këshillit të Ministrave për qasjen në arsimin e lartë.

Kjo politikë zbatohet për të gjithë studentët e vitit të parë dhe për shumicën e studentëve të vitit të dytë të ciklit të parë, domethënë të gradës Baçellor të kurikulimit të ri 3+2 sipas Procesit të Bolonjës. Mirëpo, këtë nuk e kuptojnë të gjithë. Ne ishim të befashuar pa

masë që disa pjesëtarë të komunitetit vendor diplomatik të cilët e kanë vizituar UEJL-në, asnjëherë nuk i kishin lexuar as Konventën e as Rekomandimet, dhe, rrjedhimisht, ne ishim të detyruar t'ua shpjegojmë në detaje ato dokumente. Tani ata i kuptojnë mirë ato, sepse ne u kemi treguar shumë gjëra lidhur me to.

Pa marrë para sysh se cilën politikë ne përvetësojmë, ato duhet të kalojnë filtrin e Këshillit për Licencim dhe Akreditim të Republikës së Maqedonisë, pasi që kurset të cilat nuk tregojnë kompetenca të kërkuara profesionale nuk do të pranohen për njohjen e diplomave. Përfundimi me sukses i një programi të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë, si edhe në vendet e tjera fqinje, deri ma tash janë mbështetur në aftësinë për të mësuar faktet dhe për t'i përsëritur ato në një provim me shkrim, në dëm të përvetësimit të kompetencave, përfshirë edhe kompetencën gjuhësore. Si duket, do të duhen përshtatje të shumta të programeve studimore pas miratimit të cikleve të para e të dyta '3 plus 2' në vend të '4 plus 1' prej tetorit të vitit 2005, me qëllim të pikasjes së një balanca ndërmjet nxënies së lëndëve profesionale dhe përvetësimit të shkathtësive gjuhësore.

7. Zhvendosja kah anglishtja

Tashmë është e qartë se duke pasur parasysh nivelin e lartë të konkurrencës në tregun e ri të arsimit të lartë nga sistemet e tjera jashtë rajonit të Evropës Juglindore, në veçanti nga Shtetet e Bashkuara, dhe financimin relativisht të dobët të arsimit publik, e vetmja mënyrë për një student që të arrijë qëllimet personale, ku përfshihet edhe standardi i lartë i jetesës, është njohja e mirë e një gjuhe ndërkombëtare, që në praktikë do të thotë njohje të gjuhës angleze. Është e pranuar se suksesi në botën moderne në të shumtën e lëndëve, pos atyre të rëndësishme ekskluzive vendore, varet nga njohja e mirë e një gjuhe ndërkombëtare të lidhur me fushën e lëndës. Kjo nuk është kështu vetëm për arsye profesionale. Bashkimi Evropian konsideron se mësimi i komunikimit në gjuhë të përbashkëta ndihmon në luftimin e ksenofobisë dhe të revanshizmit ultranacionalist si pengesa parësore ndaj mobilitetit evropian dhe integritetit, dhe si kërcënim kryesor stabilitetit dhe funksionimit të shëndoshë të demokracisë.

Se a duhet zhvilluar mësimi vetëm në gjuhën angleze është një çështje tjetër që do trajtim të veçantë. Ne filluam universitetin me kurse të detyrueshme në gjuhën angleze, por vetëm disa ligjërata janë mbajtur në këtë gjuhë, pasi që pak kush mund të zhvillonte mësimin në këtë gjuhë dhe sepse vetëm një numër shumë i vogël i studentëve dinte mjaftë anglisht për të kuptuar ato ligjërata apo materialet në bibliotekë, një numër i madh prej të cilave ishin dhuruar nga SHBA-ja. Procesverbalet nga mbledhjet e para të Fondacionit Ndërkombëtar i cili e themeloi UEJL-në tregojnë një tendencë nga disa anëtarë të tij që të përfillet modeli i "Universitetit Amerikan" siç kishte ndodhur në Bullgari ose në Kirgizistan – dhe siç është tash në Kosovë – madje deri në masën sa do t'i refuzohej diplomimi cilitdo student që nuk ka kompetencë të plotë gjuhësore në gjuhën angleze. Megjithatë, në fund kjo nuk u miratua pasi që ishte e qartë se një gjë e tillë ishte jopraktike duke pasur para sysh misionin e UEJL-së dhe 'klientelën' e studentëve që do të mësonin këtu.

UEJL insiston që nuk ndihmohet zhvillimi social dhe ekonomik i vendit ose i rajonit nëse bëhen përpjekje për të përjashtuar gjuhët vendore nga procesi i mësimdhënies, siç ndodh me disa ofrues privatë, pos tjerash edhe për arsye se profesorët me tituj ende nuk janë në gjendje të japin mësim në gjuhën angleze. Ligji parasheh ose mësimdhënie në "gjuhën e komuniteteve", që praktikisht do të thotë në gjuhën shqipe, ose në gjuhët e huaja. Qasja e përzier domethënë se edhe maqedonishtja duhet të mësohet. Politika e përdorimit fleksibil ka kosto të lartë. Tani qëllimi është më praktik: të arrihet niveli B2 siç përkrahur

në rregulloret e Këshillit të Evropës të paraqitura në web-faqen e Këshillit. Prej kësaj ne shkojmë tutje, duke pasur para sysh se personeli tashmë është më i aftësuar ose pranohet me nivel më të lartë startues të gjuhës angleze (me shpenzimet kryesore për zhvillimin e personelit të mbuluar nga USAID e jo nga evropianët), deri në nivelet C1 dhe C2 në disa lëndë në vitet e fundit të ciklit të parë ose në ciklin e dytë – domethënë në shkallën 'master' në lëndët e sektorit privat (biznesi dhe llogaritja). Megjithatë, arritja e kësaj nuk bazohet vetëm në numrin e orëve të dëgjura në UEJL: shumë studentë arrijnë në UEJL pasi të kenë arritur nivelin A1 ose A2. Sigurimi i mësimi të gjuhës angleze nuk është përgjegjësia e vetme e Universitetit brenda Kornizës së Përbashkët. Siç bëhet shumë e qartë në të, është e domosdoshme që nxënia e gjuhës së përbashkët të inkurajohet, të vendoset në nivel të organizuar dhe të financohet në të gjitha nivelet nga organet kompetente. Kështu që shteti ka përgjegjësinë që të inkurajojë dhe të financojë nxënien e gjuhës në të gjitha nivelet. UEJL-ja, me përkrahjen financiare të shtetit, mund ta ndihmojë këtë duke siguruar mësimdhënës të aftësuar mirë të gjuhës në shkollat me mësim në gjuhën shqipe. UEJL po ashtu ka të drejtë të kërkojë nga qeveria të ndihmojë në mbulimin e shpenzimeve për sigurimin e mësimi të cilësisë së lartë për interes të vendit, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende.

Ne u japim rendësi më të madhe gjuhëve vendore - shqipes dhe maqedonishtes - në lëndët e sektorit publik për një arsye të rëndësishme. Nëse ne diplomojmë 500 juristë (gjë që edhe do ta bëjmë), 400 prej tyre do të punojnë në praktikën juridike të Maqedonisë. Nuk ka kuptim që ata të njohin mirë gjuhën angleze nëse nuk dinë sa duhet shqip dhe maqedonisht. Për këtë arsye, ata duhet të jenë të aftësuar mirë në gjuhët vendore. Edhe për Administratën Publike vlen e njëjta: nëse shqiptarët duan të kenë qasje në administratën publike të Maqedonisë ata duhet të mësojnë gjuhën maqedone sepse kjo është gjuha e parë zyrtare e vendit. Ndërkaq në pedagogji, nëse një i diplomuar do të shkojë të japë mësim në një shkollë me mësim në gjuhën shqipe, ai ose ajo duhet të jetë në gjendje të flasë dhe të shkruajë mirë në këtë gjuhë. Mua më habit shumë, por jo edhe kolegët e mi në UEJL, sa të papërgatitur në shkrim dhe në lexim vijnë studentët madje edhe në gjuhën shqipe.

8. Hapat e mëtejme

Tash për vitin e ardhshëm presim ndryshime në ligj; deri në kohën kur do të jetë botuar ky shkrim ne do të kemi pasur, si edhe gjetkë në botë, një palë zgjedhje tjera në Maqedoni dhe, kuptohet, një qeveri të re dhe një parlament të ri më vonë këtë vit. Në ligjin e ri për arsimin e lartë shpresojmë të shohim më shumë hollësi për implementimin e Procesit të Bolonjës, më shumë autonomi për universitetet, dhe një qasje më fleksibile. Në veçanti mendojmë se nuk duhet të detyrohemi të japim mësim në gjuhën maqedonase, kjo do të duhej të ishte një konsensus ndërmjet njerëzve. A dëshironi të mësoni gjuhën maqedone? Kuptohet se po, sepse po të dëshirosh të punosh në një komunitet vendor do të duhet të mësosh të dyja gjuhët.

Terreni është përgatitur për një hap të ardhshëm të mundshëm nëse Ligji liberalizohet edhe më gjatë vitit akademik 2006 – 2007. Mund të parashohim një program bazë prej një ose dy vitesh si pjesë e Kornizës kombëtare maqedone të kualifikimeve, në të cilën studentët përqendrohen në fitimin e shkathtësive në gjuhë, teknologji informative dhe në shkathtësi të tjera të përgjithshme që çojnë deri në praninë ose në përfundim të vitit të parë të ciklit të parë tre-vjeçar për diplomë, varësisht nga aftësitë dhe nga cilësia e punës. Pas kësaj, lëndët profesionale do të mund të mësoheshin në gjuhën angleze. Megjithatë, ligji i tanishëm nuk lejon programe studimore të cilat u përgjigjen nevojave të studentëve. Siç është tani, të gjithë studentët të cilën hyjnë të studiojnë në UEJL duhet të hyjnë në provimin TOEFL (para – TOEFL) nëse duan të regjistrohen. Rezultatet paraqesin një pjesë të pikëve të kërkuara

për pranim. Për studentët e ardhshëm në të gjitha fakultetet kërkohet një rezultat minimal prej 300 pikësh (testi para – TOEFL ka një maksimum prej 500 pikësh). Pos kësaj, rezultatet e TOEFL do të përdoren për të vendosur studentët në kursin përkatës të Kursit Themelor të Gjuhës Angleze. Fakultete të ndryshme në UEJL kërkojnë nivele të ndryshme të njohjes së anglishtes por rezultati minimal i kërkuar lëviz prej 300 deri në 400 pikë. Nuk ka udhëzime absolute për pranimin e studentëve duke u bazuar në para-TOEFL, kështu që në praktikë, UEJL-ja mund të vendos që t'i ndryshojë këto kërkesa pranimi varësisht nga kërkesa. Kjo lejon futjen graduale në zbatim të mësimdhënies në gjuhën angleze në vitin e tretë të ciklit të parë, ndërsa në ciklin e dytë në kurset e Administratës së Biznesit, Kompjuterëve, dhe Llogaritjes, me mundësi të vënies në dispozicion të mësimdhënies në gjuhën angleze edhe të Juridikut (e drejta private e publike ndërkombëtare dhe e drejta evropiane). Kjo nënkupton një ristrukturim strategjik të kurseve themelore dhe të atyre speciale të anglishtes

9. Përmbyllje

Çështjet e gjuhës janë të një rëndësie fundamentale për komunitete të ndryshme të cilat gjenden në vendet e Evropës Juglindore. Duke ruajtur dhe mbrojtur përdorimin e tyre në arsimin e lartë dhe, në të njëjtën kohë, duke u krijuar studentëve mundësitë për të mësuar gjuhën angleze si një medium të komunikimit ndërkombëtar, institucionet mund të rritin gjasat për punësim dhe zhvillim personal të studentëve të vet. Megjithatë, është e domosdoshme që ligjet ta njohin këtë. Përderisa legjislativi i tanishëm i Kosovës / UNMIK-ut dhe i Bosnjë e Hercegovinës nuk parashohin kurrfarë pengesash për këto zhvillime, prapëseprapë të dyja këto vende kanë edhe shumë për të bërë derisa t'i zbatojnë ato. Për dallim, ligji maqedonas është ende paksa kufizues dhe pa dyshim ka nevojë për përmirësim nëse synohet realizimi i plotë i qëllimeve të paravëna për UEJL-në dhe shpërndarja e tyre në pjesë të tjera të sistemit të arsimit të lartë në Maqedoni.

UEJL gjithsesi paraqet një model, mirëpo modeli nuk mund të kopjohet nëse këtë nuk e lejojnë kushtet ligjore dhe ekonomike. Dhe do të përfundoj ashtu si e fillova, tri elementet: udhëheqja e mirë, mbështetja vendore dhe financimi adekuat, janë thelbësore për suksesin e cilësdo ndërmarrjeje të këtij lloji. Sipas mendimit tim, asnjë formë e "zgjidhjes së imponuar" nuk do ketë sukses.

Endnotes

¹Asociacioni i Universiteteve Evropiane (AUE): Raport i vlerësimit institucional të UEJL (2005).

²CIA World Factbook 2005: Maqedonia.

³Kjo ndodhi pas takimeve në mes të rektorit dhe personelit tjetër të UEJL-së me zyrtarët e tjerë të rëndësishëm të Këshillit të Evropës në Strazburg.